

Institucioni i Avokatit të Popullit

Programi i Përherëshëm për të Drejtat e Fëmijëve



17 qershor 2025

1. PËRMBAJTJA

HYRJE	3
PJESA 2: ÇKA ËSHTE FËMIJA DHE CILAT JANË TË DREJTAT E TYRE SIPAS KDF-së?.....	11
Pjesa 3.1: RAST STUDIMI MBI NDËSHKIMIN TRUPOR NË KOSOVË.....	25
Pjesa 3.2: RAST STUDIMI MBI PUNËT FIZIKE TË NDALUARA PËR FËMIJËT NË KOSOVË	30
Pjesa 4: SI MBROHEN TË DREJTAT E FËMIJËVE KOSOVARË NË NIVEL REGJIONAL DHE KOMBËTAR?	31
PJESA 5: ÇKA ËSHTE INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT TË KOSOVËS?	36
PJESA 6: SI TA RAPORTOJ SHKELJEN E TË DREJTAVE TË MIA?	40
PËRMBYLLJE	44
SHTOJCAT	44
Aneksi A: Formulari i vetëreflektimit	44
Aneksi B: Kartolinat e KDF-së për fëmijët më të vegjël	47
Aneksi C: Kartolinat e KDF-së për fëmijët më të mëdhenj	47

HYRJE

Ky program synon të ndërgjegjësojë fëmijët për të drejtat e tyre dhe rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) në mbrojtjen e këtyre të drejtave sipas Kushtetutës, Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe legjislacionit në fuqi në Kosovë.

Ky dokument shërben si udhëzues për prezantuesit dhe është krijuar për t'u përdorur nga stafi i IAP-së për të ofruar trajnime për të drejtat e fëmijëve për fëmijët në shkollat anembanë Kosovës. Qëllimi i këtij programi është t'u japë fëmijëve një pasqyrë hyrëse për të drejtat e tyre, mbrojtjes që u ofrohet atyre në bazë të KDF-së, të drejtat e tyre me legjislacionin rajonal dhe kombëtar dhe si duhet të veprojnë nëse u shkelen këto të drejta. Ky qëllim gjithashtu përfshin vetëdijësimin e fëmijëve për rolin e IAP-së në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Programi përmbush vizionin e Parlamentit të Republikës së Kosovës, të përcaktuar në nenin 18.1.3 të Ligjit nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, i cili thotë: *“Avokati i Popullit ka këto përgjegjësi: [...] 1.3. të hartojë dhe miratojë procedura specifike për marrjen dhe trajtimin e ankesave nga fëmijët dhe krijimin e një ekipi të specializuar për të drejtat e fëmijëve dhe një program të përhershëm që fëmijët të ndërgjegjësohen për të drejtat e tyre dhe rolin e institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e tyre.”*¹

Programi për Prezantuesit është krijuar për të qenë një burim njohurie për stafin e IAP-së për të ofruar një trajnim 2-orësh për fëmijët në shkollat anembanë Kosovës. Ai shoqërohet nga dy prezantime në PowerPoint, të cilat janë krijuar njëkohësisht dhe bashkërisht me këtë Udhëzues dhe janë shkruar në gjuhën e përshtatshme për moshën e fëmijëve. Një prezantim PowerPoint është krijuar për fëmijët e moshave 8 – 11-vjeçare dhe tjetri është krijuar për fëmijët më të mëdhenj të moshave 12 – 18-vjeçare.

Për më tepër, ky program përmban disa burime në formë aneksesh:

- **Aneksi A:** Formulari i vetëreflektimit për fëmijët që duhet të plotësohet në fillim dhe në fund të trajnimit.
- **Aneksi B:** Kartolinat e KDF-së për fëmijë (moshat 8 – 11-vjeçare).
- **Aneksi C:** Kartolinat e KDF-së për fëmijë (moshat 12 – 18-vjeçare).

Ky dokument është projektuar si një hyrje gjithëpërfshirëse në temë dhe për këtë arsye nuk duhet parë si një pamje e plotë e fushës. Është krijuar për t'iu paraqitur fëmijëve me njohuri minimale të të drejtave të fëmijëve. Nëse fëmijët kanë pyetje më gjithëpërfshirëse për temat e ngritura, ata duhet të inkurajohen t'i eksplorojnë ato në shkollë ose në mënyrë të pavarur. Fëmijëve mund t'u ofrohen edhe burime të tjera informative ndihmëse, duke përfshirë:

- [faqen e internetit të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës](#)
- [faqen e internetit të UNICEF-it në Kosovë](#)
- [faqen e internetit të Zyrës së Komisionarit të Lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara \(OKB\) për të Drejtat e Njeriut në UNCRC](#)

Kur planifikoni ta mbani trajnimin, ia vlen të merren parasysh disa pyetje logjistike.

Shpresojmë se kjo listë e pyetjeve të mundshme logjistike do të japë përgjigje të qarta:

¹ Theks i shtuar.

- **Mosha:** Ky trajnim është krijuar për fëmijët e moshave 8 – 18-vjeçare, të cilët aktualisht janë në shkollë. Sidoqoftë, ne e kuptojmë se fëmijët në faza dhe sfone të ndryshme zhvillimi mund të përfshihen me materialin në mënyra të ndryshme. Prandaj prezantuesit duhet të përpqen, aty ku është e mundur, t’ua përshtatin shpërndarjen e materialeve fëmijëve me të cilët angazhohen dhe të përdorin gjuhë dhe shembuj të përshtatshëm për moshën. Prezantimet në PowerPoint për dy grup-mosha të ndryshme janë ofruar për të ndihmuar në lehtësimin e kësaj detyre.
- **Pauza:** Fëmijët mund të kenë nevojë për një pushim të shkurtër prej 5 minutash për të pushuar dhe për të përdorur banjën mes trajnimit. Ju lutemi jepuni kohë për këtë.
- **Gjuha miqësore për fëmijët dhe e përshtatshme për moshën:** Ju lutemi sigurohuni që gjuha e përdorur gjatë trajnimit të jetë e përshtatshme për moshën dhe shembujt e dhënë të jenë të përshtatshëm për ta! Shmangni përdorimin e fjalorit, zhargonit dhe shkurtesave komplekse, kur është e mundur!
- **Pajisjet e nevojshme:** Për të ofruar me sukses këtë trajnim, prezantuesit do të kenë nevojë për: versione të plastifikuara të kartolinave të KDF-së (shiko anekset C dhe D), ose letra të vogla, një fletë letre me madhësi A1 për hartat mendore për çdo pesë fëmijë (shkallëzoni sipas madhësisë së klasës suaj), një kopje të formularit të vetëreflektimit për çdo fëmijë të përfshirë, një shumëllojshmëri stilolapsash dhe lapsash me ngjyra. Nëse ka projektor në dispozicion, është gjithashtu e dobishme të shfaqen prezantimet shoqëruese të PowerPoint-it duke përdorur projektor dhe laptop/kompjuter (megjithatë ky trajnim mund të ofrohet pa PowerPoint nëse nuk ka pajisje në dispozicion).
- **Madhësia e grupit:** Ky trajnim është krijuar për fëmijët në një mjedis klase, me jo më shumë se 35 fëmijë të gjinive të përziera. Megjithatë, nëse shkollat mund të kenë vetëm grupe më të mëdha, ky trajnim edhe më tutje duhet të jetë praktik, vetëm se mund të zgjasë pak më shumë se koha e parashikuar.
- **Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara:** Të gjithë fëmijët duhet të ftohen të marrin pjesë në këtë trajnim, pavarësisht nëse identifikohen si fëmijë me aftësi të kufizuara. Për të ndihmuar në lehtësimin e kësaj, prezantuesit duhet t’i kontaktojnë mësuesit përpara trajnimit për të diskutuar përshtatjet e arsyeshme për të ndihmuar përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- **Gjuhët:** Ky trajnim është zhvilluar në gjuhën shqipe dhe në atë serbe.
- **Pjesëmarrja e stafit të shkollës:** Do të ishte e dobishme të përcaktohej qysh në fillim nëse mësuesit, administratorët dhe punonjësit e tjerë të shkollës do të ishin në gjendje ta mbështesnin këtë trajnim specifik dhe cili do të ishte roli i tyre. Për t’i mbrojtur fëmijët, do të rekomandohej që edhe një person tjetër i rritur ta shoqëronte prezantuesin. Megjithatë, aty ku është e mundur, ky person nuk duhet të jetë mësues. Në vend të kësaj, ne do të sugjeronim që ky person shtesë të jetë anëtar i stafit të IAP-së. Mund të kërkohet gjithashtu personel shtesë për të ndihmuar në organizimin e logistikës (p.sh. vendosjen e projektorit dhe prezantimin), ose për t’i mbështetur fëmijët me nevoja shtesë në mjedis klase. Megjithatë vlen të merret parasysh se ka

gjasa që fëmijët të jenë më të relaksuar dhe të marrin pjesë plotësisht pa pranimë e mësuesit. Si kompromis i kësaj sugjerohet që mësuesi të jetë i pranishëm në sallë, por të mos marrë pjesë drejtpërdrejt në trajnim.

- **PowerPoint:** Ky Udhëzues i Prezantuesit shoqërohet me nga dy prezantime në PowerPoint, që përmbajnë këtë informacion në formatin “miqësor për fëmijët”. Ky Udhëzues është krijuar si një burim për t’i mbështetur prezantuesit e rritur dhe nuk duhet të ndahet drejtpërdrejt me fëmijët, në mënyrë që të mos i mbingarkojë ata. Përkundrazi, nëse fëmijët kanë pyetje lidhur me PowerPoint-in ose duan ta eksplorojnë temën më thellë, ky Udhëzues mund të përdoret si burim. Një nga prezantimet në PowerPoint është krijuar për fëmijët e moshave 8 – 11-vjeçare dhe tjetri është krijuar për fëmijët e moshave 12 – 18-vjeçare.
- **Mbrojtja:** Sigurohuni që jeni në dijeni për procedurat e IAP-së dhe të shkollave për raportimin e çdo shqetësimi në lidhje me mirëqenien e fëmijëve që ngrihet gjatë trajnimit. Ju duhet të jeni të përgatitur dhe t’i kuptoni hapat e mëtejshëm nëse një fëmijë zgjedh t’ju zbulojë shkeljen e të drejtave të tij, duke përfshirë veprimet të cilat duhet t’i ndërmerren nëse fëmija është në rrezik të menjëhershëm të dëmtimit. Ju lutemi konsultohuni me shkollën për procedurat e adresimit të shqetësimeve të fëmijëve.
- **Shënimi:** Ky Udhëzues është krijuar me “pjesë” të qarta për të lejuar fleksibilitet varësisht njohurive ekzistuese që kanë fëmijët. Secili seksion ka “shenja” të qarta për aktivitete të ndryshme:



Ikona e pjesës së enigmës në kutinë e kuqe tregon se ekziston një lojë që mund të luhet për të përfshirë më tej fëmijët në temë dhe për t’u dhënë energji. Fëmijët duhet të inkurajohen të ngrihen në këmbë/lëvizin për këto lojëra, kur është e mundur.



Ikona e llambës së dritës në kutinë e hirtë tregon se ka një pyetje për t’u përgjigjur fëmijëve, ose që ata të sugjerojnë mendime dhe ide. Kjo i lejon fëmijët dhe të rinjtë të marrin pjesë dhe të ndajnë njohuritë, megjithatë ikona shërben gjithashtu si një mënyrë efektive për prezantuesit që bashkërisht me pjesëmarrësit e trajnimit të japin një kuptim të përbashkët të temës.



Ikona e lapsit në kutinë e verdhë tregon se fëmijëve u kërkohet të vizatojnë një hartë mendore të ideve të tyre për një temë specifike, përgjithësisht në grupe të vogla me bashkëmoshatarët e tyre.



Ikona e kamerës në kutinë jeshile tregon një video që duhet t’u shfaqet fëmijëve, nëse ka qasje në projektor dhe në laptop.

- **Kohëzgjatja:** Vlerësohet se ky trajnim mund të marrë rreth dy orë për t’u mbajtur në shkollë, varësisht nga numri i pjesëmarrësve.

Fillimi

Pasi të siguroheni se të gjitha pajisjet janë në rregull, ju duhet t'i keni parasysh veprimet në vijim:

1. **Krijoni skenën dhe prezantohuni.** Qysh në fillim është e dobishme që gjatë të folurit me fëmijët të përdorni një ton të relaksuar, por profesional. Në mënyrë ideale, fëmijët duhet të ndihen të qetë dhe të aftë për të bërë pyetje gjatë trajnimit duke ngritur dorën e tyre. Shpjegojeni se do të ketë një sërë komponentësh informues në të folur, lojëra, ushtrime vizatimi dhe mundësi për të diskutuar çështje dhe për të bërë pyetje.
2. **Informoni pjesëmarrësit për qëllimin e trajnimit,** i cili do t'u japë fëmijëve një pasqyrë hyrëse të të drejtave të tyre, mbrojtjes që u ofrohet atyre në bazë KDF-së, të të drejtave të tyre përmes legjislacionit të zbatueshëm në Republikës e Kosovës dhe çfarë të bëjnë nëse të drejtat e tyre janë shkelur. Kjo përfshin sigurimin që fëmijët janë të vetëdijshëm për rolin e IAP-së në mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe si t'i raportojnë shkeljet e të drejtave të tyre.
3. **Kërkojuni fëmijëve t'i plotësojnë kopjet e printuara të Pjesës 1 të formularit të vetëreflektimit** (shih Shtojcën A). Kjo do t'i lejojë IAP-së t'i kuptojë më mirë njohuritë e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe se si ndryshojnë ato pas përfundimit të trajnimit.



Akullthyes fillestar

Sugjerimet e akullthyesve fillestarë me fëmijë janë renditur më poshtë, megjithatë prezantuesit duhet të ndihen të lirë t'i përdorin akullthyesit sipas dëshirës, duke marrë parasysh pikëpamjet e fëmijëve. Një mënyrë për ta bërë këtë mund të jetë që fëmijët të votojnë për akullthyesin e tyre të preferuar përmes një ngritjeje duarsh.

1) **Dy të vërteta dhe një gënjeshtër:** Në grupe të vogla me rreth pesë persona, të rinjtë duhet të ndajnë me njëri-tjetrin dy fakte reale për veten e tyre dhe një fakt të sajuar. Për shembull, “Këngëtarja ime e preferuar është Dua Lipa. Kafsha ime e preferuar është kali. E urrej picën!” Fëmijët atëherë duhet të hamendësojnë se cili fakt është i pavërtetë. Të gjithë fëmijët duhet të marrin pjesë (kjo do të funksiononte më mirë për fëmijët më të rritur).

2) **Më trego një histori:** Një fëmijë duhet të fillojë një tregim me 4 fjalë dhe personi tjetër t'i shtojë 4 fjalë etj. Në fund të lojës, klasa duhet të ketë së bashku një histori të tërë (kjo do të funksiononte më mirë për fëmijët më të vegjël).

3) **Ulu nëse...:** E gjithë klasa qëndron në një rreth dhe dikush bën pyetje, nëse po, njerëzit ulen (duhet hapësirë e mjaftueshme). Për shembull, dikush mund të thotë “Ulu nëse ke veshur rroba të kuqe!” ose “Ulu nëse ke kapele!” (kjo do të funksiononte për çdo moshë të fëmijëve).

4) **Tre në turmën tonë:** Ndani të rinjtë në grupe prej tre vetash. Secili ekip duhet t'i gjejë tri gjëra të përbashkëta dhe më pas të prezantohet para gjithë klasës duke i ndarë ato tri gjëra. Për shembull, “Ne të gjithë jemi 12-vjeçarë, të gjithëve na pëlqen shumë të mësojmë matematikë, të gjithë jemi në gjendje të fishkëllejme.” (kjo do të funksiononte më mirë për fëmijët më të rritur).

5) **A do të dëshironit më mirë?:** Ndani dhomën në mënyrë që gjysma e dhomës të jetë Përgjigjja 1 dhe gjysma tjetër të jetë Përgjigjja 2. Vazhdoni të bëni pyetje se a do të dëshironit më mirë, të tilla si: “A do të preferonit të ishit i padukshëm apo të mund të fluturonit?”, ose: “A do të preferonit të hanit vetëm pica për pjesën tjetër të jetës ose të hanit vetëm hamburger?” (ky akullthyes kërkon hapësirë të mjaftueshme dhe do të funksiononte për çdo moshë të fëmijëve).

Pjesa 1: Çka janë të drejtat e njeriut?

Të drejtat e njeriut janë liritë themelore, të cilat i ka çdo njeri. Çdo qenie njerëzore ka të drejtë për të njëjtat të drejta dhe liri themelore të njeriut.

Këto të drejta janë të **qenësishme dhe universale**, sepse ju keni lindur me to pavarësisht nga raca, gjinia, feja, kultura ose vendi ku jetoni. Këto të drejta të njeriut janë të **patjetërsueshme**, që do të thotë se ato nuk mund t'ju hiqen.

Të drejtat e njeriut janë **të pandashme, të ndërlidhura dhe të ndërvarura**, sepse përmirësimi i një të drejte çon në avancimin e të tjerave. Heqja e njëres të drejtë ndikon negativisht te të drejtat e tjera. Askush nuk mund të respektojë disa të drejta dhe jo të tjerat.

Të drejtat e njeriut garantohen nga legjislacioni i të drejtave të njeriut nëpërmjet traktateve, së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe burimeve të tjera të së drejtës.



Duart lart!

A mund të kujtoni ndonjë të drejtë të njeriut?

Shembuj të tjerë të të drejtave të njeriut përfshijnë: e drejta për jetën, e drejta për liri, ndalimi i skllavërisë, ndalimi i torturës, e drejta për të mos u diskriminuar, e drejta për gjykim të drejtë, e drejta për kombësi, e drejta për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë dhe e drejta për arsimim.



Lojë: Qëllo të drejtën e njeriut!

Të gjithë fëmijëve duhet t'u jepet një shans për t'i parë kartolinat e KDF-së. Duhet t'u shpjegohet se këto kartolina do t'u jepen gjatë gjithë trajnimit dhe secila përmban një nga të drejtat që kemi sipas KDF-së.

Në grupe të vogla me 5-10 fëmijë, kërkoni nga një fëmijë nga secili grup të zgjedhë një kartolinë. Për ta bërë këtë më të lehtë, duhet të filloni me një numër të vogël kartolinash kyçe, në mënyrë që fëmijët të kenë një ide mbi opsionet në dispozicion. Ata nuk duhet t'ia tregojnë kartolinën pjesës tjetër të grupit. Duke përdorur vetëm pyetjet “po” ose “jo”, pjesa tjetër e fëmijëve në grup duhet të përpiqet dhe të gjejë se cila është e drejta.

Kështu, për shembull, nëse fëmija mban nenin 12 (Të drejtën për të marrë pjesë dhe për t'u dëgjuar zëri i tyre), fëmijët mund të pyesin: A është e drejtë që ka të bëjë me shkollën? A është e drejtë që ka të bëjë me shëndetin?

Nëse grupi ka nevojë për ndihmë, ata mund të kërkojnë një “ndihmë” nga fëmija që mban kartolinën. Pra, në këtë shembull, fëmija mund të thotë: “Ka të bëjë me demokracinë.”, ose diçka të ngjashme.

Këto të drejta dhe të tjera mund të gjenden në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila u shpall në vitin 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, si një standard i përbashkët për të gjithë popujt dhe të gjitha kombet. Kjo ishte hera e parë që Kombet e Bashkuara përcaktuan të drejtat themelore të njeriut për t'u mbrojtur në mënyrë universale në mbarë botën.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të të drejtave të njeriut.² Një kategori e të drejtave të njeriut janë “*Të drejtat civile dhe politike*”, që përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi; të drejtën për lirinë e fesë dhe lirinë e fjalës. Një kategori tjetër e të drejtave janë “*Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore*”. Shembujt përfshijnë të drejtën për ushqim, strehim, arsim, kujdes shëndetësor dhe sigurim social të mjaftueshëm. Edhe pse të drejtat mund të ndahen në kategori të ndryshme, të gjitha të drejtat e njeriut janë të ndërlidhura. Kjo do të thotë se një e drejtë e përcaktuar nuk mund të gëzohet pa tjetrën.

Aktualisht ekzistojnë nëntë traktate “thelbësore” të të drejtave të njeriut.³ Secila mbulon një fushë të ndryshme, duke përfshirë:

1. Të drejtat civile dhe politike. Për shembull, e drejta për një gjykim të drejtë, e drejta për lirinë e shprehjes.
2. Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Për shembull, e drejta për arsimim, e drejta për sigurim social, e drejta për punë.
3. Torturën dhe trajtimin ose ndëshkimin mizor, çnjerëzor ose poshtërues. Për shembull, kjo siguron që qeveria ose aktorët e tjerë shtetërorë nuk mund t'ju lëndojnë kur jeni në burg.
4. Diskriminimin racor. Për shembull, kjo siguron që të gjithë në një vend – pa marrë parasysh racën, ngjyrën, kombësinë ose origjinën etnike – t'i kenë të njëjtat të drejta ligjore.
5. Diskriminimin gjinor. Për shembull, ky traktat përcakton hapat e qartë që vendet duhet t'i ndërmarrin për t'i avancuar të drejtat e grave (d.m.th. diskriminimin në punësim, dhunën në baza gjinore dhe/apo sigurimin e mbrojtjes së veçantë për gratë shtatzëna).
6. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Për shembull, personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të jetojnë në komunitet (jo në një institucion) dhe shteti detyrohet të sigurojë që ata të mbështeten dhe të përfshihen plotësisht.

² Kombet e Bashkuara, ‘Çështjet Globale të të Drejtave të Njeriut’, Në dispozicion: <https://www.un.org/en/global-issues/human-rights>, qasur më 7 korrik 2022.

³ Zyra e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara, Instrumentet Themelore Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe organet e tyre monitoruese, në dispozicion: <https://www.ohchr.org/en/core-international-human-rights-instruments-and-their-monitoring-bodies>, qasur më 7 korrik 2022.

7. Mbrojtja e të gjithë personave nga zhdukja me dhunë. Për shembull, ky traktat përcakton që të gjithë – pavarësisht se kush janë apo çfarë po ndodh në një vend – nuk mund të zhduken me dhunë.

8. Të drejtat e punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Për shembull, këtu përcaktohen të drejtat e punëtorëve migrantë dhe të familjeve të tyre që të mos detyrohen të punojnë.

9. Të drejtat e fëmijës. Për shembull, e drejta për t'u dëgjuar, e drejta që interesi më i mirë i fëmijës të merret në konsideratë kur merren vendime që ndikojnë në jetën e tyre.

Kush ka të drejta të njeriut?

Të drejtat e njeriut janë universale dhe në to kanë të drejtë të gjithë. Të gjitha të drejtat e njeriut janë njësoj të rëndësishme dhe duhet të respektohen nga të gjithë. Askush nuk mund t'ju heqë ato si dhe as ju nuk mund të hiqni dorë prej tyre, por ato mund të kufizohen në rrethana të jashtëzakonshme.

Për shembull, shteti mund ta kufizojë të drejtën e dikujt për liri duke e futur në burg nëse ai ka kryer një krim të rëndë, ose një shtet mund t'i kufizojë të drejtat për shkak të shqetësimeve për sigurinë kombëtare.

Kur një shtet kufizon të drejtat e njeriut për shkaqe të arsyeshme dhe duke ndjekur proceset e duhura, kjo nuk përbën shkelje të kësaj të drejte. Shpesh gjykatat kombëtare dhe ndërkombëtare ndihmojnë për të vendosur nëse kufizimet e të drejtave të njeriut përbëjnë shkelje apo jo.

Si mund të na mbrojnë të drejtat e njeriut?

Të drejtat e njeriut mund t'ju mbrojnë në jetën e përditshme nga njerëzit e tjerë, grupet dhe shteti. Në nivel ndërkombëtar, kjo mund të përfshijë nënshkrimin e traktateve dhe konventave nga shtetet.



Duart lart!

Pyetje për fëmijët më të rritur:

Py: A e di dikush se çka është konventa apo traktati?

P: Traktati ose konventa është marrëveshje midis vendeve të ndryshme.

Pyetje për fëmijët më të vegjël:

Py: A mund të mendoni për një çast se kur keni bërë një premtim të rëndësishëm?

Ndërlidheni me llojet e premtimeve nga e drejta ndërkombëtare. Shpjegoni se traktatet dhe konventat janë si premtime që vendet bëjnë për të bërë gjëra të caktuara, si mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Shembuj të traktateve të të drejtave të njeriut përfshijnë: Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racor dhe Konventën për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave. Kur shtetet nënshkruajnë traktate ndërkombëtare, ato bien dakord të jenë të lidhur ligjërisht ndaj tyre. Kjo do të thotë se shtetet duhet t'i ndjekin rregullat e përcaktuara në traktat. Kur ka një problem me të drejtat e njeriut, një individ që pretendon se i janë shkelur të drejtat, mund të paraqesë një ankesë individuale pranë Komitetit përkatës të OKB-së.

Në nivel kombëtar, të drejtat e njeriut mund të mbrohen nga organizatat shtetërore. Për shembull, organet policore mund të mbrojnë dikë nga dhuna, një spital mund të ofrojë kujdes shëndetësor, ndërsa shkollat ofrojnë arsim. Gjykatat kombëtare mund të luajnë gjithashtu një rol në garantimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke i mbajtur njerëzit ose organizatat përgjegjëse kur shkelin të drejtat e njeriut.

PJESA 2: ÇKA ËSHTË FËMIJA DHE CILAT JANË TË DREJTAT E TYRE SIPAS KDF-SË?

Çka është fëmija?

Ndërkombëtarisht sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës, fëmijë është “*çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare*”.⁴

Çka janë të drejtat e fëmijëve?


Të drejtat e fëmijëve janë “liri” ose “standarde”, në të cilat të gjithë fëmijët kanë të drejtë. Të drejtat e fëmijëve janë të drejta të njeriut. Ndërsa të drejtat e njeriut janë të zbatueshme për të gjithë njerëzit, të drejtat e fëmijëve zbatohen vetëm për fëmijët si mbrojtje shtesë “përveç” të drejtave themelore të njeriut.

Këto të drejta “plotësuese” për fëmijët janë të rëndësishme për të siguruar që fëmijët janë të mbrojtur dhe të aftë të marrin pjesë duke pasur parasysh pozicionin e tyre unik si njerëz që udhëzohen dhe mbështeten nga të rriturit për t'u ushqyer teksa rriten drejt pavarësisë. Fëmijët nuk janë pronë e prindërve të tyre, por janë qenie njerëzore me të drejtat e tyre. Këto të drejta duhet të mbrohen dhe të realizohen që fëmijët ta zhvillojnë potencialin e tyre të plotë.

Të drejtat e fëmijëve janë universale për të gjithë njerëzit e moshës nën 18-vjeçare, por si edhe të drejtat më të gjera të njeriut, ato mund të kufizohen në rrethana specifike. Një shembull i mirë i kësaj është “E drejta për liri” - në shumicën e vendeve, nëse një person dënohet për një krim të rëndë, liria e tij mund të kufizohet në përputhje me ligjet vendore. Kjo nuk është një shkelje e të drejtave, për sa kohë ajo ndjek të drejtat e njohura si “proces i rregullt”, që do të thotë se personi ka një gjykim të drejtë dhe trajtohet në mënyrë të drejtë nga gjykatat dhe nga sistemi më i gjerë i drejtësisë penale.

⁴ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta e A.P. 44/25, Aneksi 44, 2 shtator 1990.

Fëmijët janë “bartës të të drejtave”. Shteti është “bartës i detyrës”. Kjo do të thotë se shteti ka përgjegjësinë për t’u siguruar që të drejtat tuaja mbrohen dhe ju mësoni për të drejtat tuaja.



Duart lart!

A keni dëgjuar ndonjëherë më parë për të drejtat e fëmijëve? Çka dini për to?

Kush mbron të drejtat tona?



Duart lart!

Kush mendoni se duhet t'i mbrojtë të drejtat tuaja?

Të gjithë janë përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të të drejtave të fëmijëve, përfshirë të gjithë ata që janë ulur këtu sot. Disa njerëz janë më të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave tona se të tjerët, duke përfshirë:

1) Shtetin

“Shteti” do të thotë qeveria dhe organe të tjera përgjegjëse për marrjen e vendimeve (p.sh. Policia, Ministria e Arsimit etj.). Në të njëjtën mënyrë sikurse çdo individ duhet t'i respektojë të drejtat e fëmijëve, edhe shteti duhet t'i respektojë të drejtat e fëmijëve. Megjithatë, si “bartës i detyrës”, shteti ka një detyrë shtesë për t'i mbrojtur të drejtat e fëmijëve. Kjo do të thotë se shteti gjithashtu duhet të ndërmarrë masa për t'i mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e fëmijëve.

Ka shumë mënyra se si një shtet mund t'i mbrojtë të drejtat e fëmijëve. Një mënyrë është miratimi i ligjeve për t'i mbrojtur të drejtat e fëmijëve. Kjo mund të përfshijë miratimin e ligjit që ndalon vrasjen - për ta parandaluar marrjen e jetës së një fëmije. Kjo mund t'i përfshijë gjithashtu rregulloret e trafikut që kërkojnë nga shoferët ta ulin shpejtësinë e tyre afër shkollave dhe këndeve të lojërave për t'i mbrojtur fëmijët.

Një mënyrë tjetër se si shteti mund t'i mbrojtë të drejtat e fëmijëve është nëpërmjet institucioneve shtetërore. Kjo përfshin të gjitha agjencitë qeveritare në nivel qendror dhe lokal. Për shembull, shteti mund të ofrojë kujdes shëndetësor cilësor dhe falas për të gjithë fëmijët, në mënyrë që ata ta kenë kujdesin dhe trajtimin e duhur mjekësor për t'u rritur, zhvilluar dhe përmbushur potencialin e tyre. Departamentet e imigracionit mund t'i shqyrtojnë aplikimet nga një familje në tërësi për të siguruar që fëmijët të mos ndahen nga prindërit e tyre kundër vullnetit të tyre. Shteti mund të sigurojë që të gjithë fëmijët të kenë qasje në arsimim falas dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë edukimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe pajisjen e tyre me aftësi jetësore për të pasur një të ardhme të suksesshme.

2) Prindërit/kujdestarët


Prindërit dhe kujdestarët janë gjithashtu përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Prindërit dhe kujdestarët duhet të marrin në konsideratë atë që është më e mira për fëmijën e tyre kur marrin vendime për edukimin e tyre për të mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e fëmijëve të tyre. Për shembull, ata mund të përmbushin të drejtën e fëmijës së tyre për arsimim duke u siguruar që fëmija i tyre të shkojë në shkollë.

Fëmijët gjithashtu kanë të drejtë të jetojnë një jetë pa dhunë. Si të tillë, prindërit dhe kujdestarët nuk mund të përdorin ndëshkimin trupor ose forma të tjera të dhunës, abuzimit ose neglizhencës në shtëpi si një mënyrë për të ndëshkuar sjelljen e fëmijëve. Duke bërë këtë, ata ndihmojnë për të mbrojtur të drejtën e fëmijëve për siguri dhe një mjedis familjar gjithashtu.

3) Organizatat ndërkombëtare

Jashtë Kosovës, organizatat ndërkombëtare monitorojnë shtetet për të siguruar që të drejtat e fëmijëve mbrohen. Kombet e Bashkuara janë organi kryesor përgjegjës për këtë.

Këto organizata mund të mbështesin vendet për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Për shembull, Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara (UNICEF) mund të ndërmarrë një analizë të situatës së fëmijëve në një vend të caktuar dhe t'i ndihmojë ata të përmirësohen duke punuar me qeveritë për të vendosur objektiva dhe për të zbatuar programe për të mbështetur ndryshimin e synuar. Kur një shtet ka shkelur të drejtat e fëmijëve, mund të jetë e nevojshme që komuniteti ndërkombëtar të ndërmarrë veprime, për shembull nëpërmjet Gjykatës Penale Ndërkombëtare. Meqenëse shtetet janë shpesh të fuqishme dhe mund të jetë e vështirë për individët t'i mbajnë përgjegjëse qeveritë e tyre, këto organizata mund të ofrojnë një mbrojtje shtesë.



Ushtrim: Kush i mbrohet të drejtat tona?

Kërkojuni fëmijëve të formojnë grupe të vogla me 5 persona. Jepjani secilit grup një copë letër të bardhë A1 dhe kërkoni të krijojnë një hartë mendore të ideve të tyre se si individët, prindërit, mësuesit, zyrtarët e policisë, mjekët dhe të tjerët mund t'i mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Kjo nuk duhet të zgjasë më shumë se 10 minuta.

Çka është OKB-ja?

Kombet e Bashkuara, ose OKB-ja, është një organizatë që përfshin pothuajse të gjitha vendet në botë. Aktualisht janë 193 shtete anëtare të OKB-së.⁵ Kosova ende nuk është anëtare e OKB-së. OKB-ja u krijua në 1945 dhe roli i saj është t'i lehtësojë bisedat midis kombeve të botës, t'i lejojë ato të mblidhen së bashku për t'i diskutuar problemet e përbashkëta dhe për të gjetur zgjidhje të përbashkëta.⁶

Qëllimet kryesore të OKB-së janë ruajtja e paqes botërore, përmirësimi i jetës së njerëzve dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut. Një mënyrë që OKB-ja ndihmon në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve është përmes monitorimit të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës.

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët është agjencia e OKB-së - përgjegjëse për ofrimin e ndihmës humanitare dhe zhvillimore për fëmijët në mbarë botën.⁷

Çka është Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës?

KDF-ja është një marrëveshje midis vendeve të ndryshme. Të gjitha vendet kanë rënë dakord t'i mbrojnë të drejtat e fëmijëve. KDF-ja ka gjithsej 54 nene që mbulojnë të gjitha aspektet e jetës së një fëmije:

- nenet nga 1 deri në 41 përcaktojnë të drejtat se si fëmijët dhe të rinjtë duhet të trajtohen në mënyrë që ata të jenë të sigurt, të shëndetshëm dhe të lumtur;
- 13 nenet e tjera kanë të bëjnë me mënyrën se si qeveritë, organizatat dhe të rriturit duhet të punojnë së bashku për të siguruar që fëmijët të kenë qasje në këto të drejta.

KDF-ja është traktati ndërkombëtar për të drejtat e njeriut më i ratifikuari në histori. Kjo tregon pajtimin global që të gjithë fëmijët kanë të drejta që duhen mbrojtur.



Duart lart!

A mund ta qëllojë dikush se sa vende e kanë nënshkruar KDF-në?

Përgjigjja: 196

Fakt interesant: I vetmi vend në botë që nuk e ka nënshkruar KDF-në janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës!

Të drejtat e KDF-së shpesh ndahen në tri grupe:

⁵ Kombet e Bashkuara, Rreth nesh. Në dispozicion: <https://www.un.org/en/about-us>, qasur më 7 korrik 2022.

⁶ Kombet e Bashkuara, Rreth nesh. Në dispozicion: <https://www.un.org/en/about-us>, qasur më 7 korrik 2022.

⁷ UNICEF, për UNICEF-in. qasur: <https://www.unicef.org/about-unicef>

1. **Mbrojtja:** E drejta për t'u mbrojtur nga veprimet dhe sjelljet.
2. **Ofrimi:** E drejta për të pasur qasje në përfitime, shërbime ose aktivitete që nxisin rritjen dhe zhvillimin.
3. **Pjesëmarrja:** E drejta për t'u përfshirë në aktivitete dhe për të marrë pjesë në vendime.

Edhe kur përdoren këto kategori, të drejtat e përfshira në KDF janë të ndërruar dhe të pandashme. Nuk është i mundur promovimi dhe mbrojtja e të drejtave në mënyrë të izoluar pa i marrë parasysh edhe të drejtat e tjera.

Disa shembuj të të drejtave që janë të përfshira:

- E drejta për të qenë të lirë nga dhuna (neni 19): Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të mbrohen nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe neglizhencës, pavarësisht se kush e kryen dhunën. Kjo përfshin dhunën që mund të normalizohet në disa familje dhe komunitete, të tilla si ndëshkimi trupor nga prindërit ose kujdestarët (p.sh. goditja) ose ngacmimi nga fëmijët e tjerë. Shteti ka përgjegjësinë t'ju mbrojë nga dhuna dhe të veprojë në interesin tuaj (të fëmijëve) më të mirë nëse keni përjetuar dhunë në çfarëdo forme.
- E drejta për të jetuar një jetë pa diskriminim (neni 2): Të gjithë fëmijët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë për të jetuar pa u diskriminuar. Ky vlen pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, politika/opinionet e fëmijës (prindit ose kujdestarit të tij/saj), origjina kombëtare, etnike ose sociale, pasuria, aftësia e kufizuar, lindja ose statusi tjetër.
- E drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për një jetë të plotë dhe të denjë (neni 23): Fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore dhe/ose fizike duhet t'u ofrohet kujdes i veçantë për t'u siguruar se ata janë në gjendje të jetojnë një jetë të plotë në kushte që sigurojnë dinjitet, promovojnë vetëmbështetjen dhe lehtësojnë pjesëmarrjen aktive të fëmijës në komunitet. Duke njohur nevojat e veçanta të fëmijës, kjo duhet të përfshijë, për shembull, ndihmën për qasje në arsim, trajtim, kujdes shëndetësor dhe shërbime rehabilitimi.
- Të drejtat e fëmijëve në përkujdesje për mbrojtje dhe mbështetje (nenet 20, 25, 9 dhe 3): Fëmijët që janë larguar përkohësisht nga kujdesi i prindërve të tyre – kur është në interesin e tyre më të mirë për ta bërë këtë – kanë të drejtën për kujdes të veçantë dhe ndihmë nga shteti. Kjo ndihmë duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Aty ku është i nevojshëm kujdesi institucional, mund të përdoret, por mundësitë alternative të kujdesit (p.sh. kujdestaria, birësimi) duhet të jenë gjithashtu në dispozicion për fëmijët.
- Të drejtat e fëmijëve në situatë rruge (Komenti i Përgjithshëm Nr. 21 i KDF-së): Fëmijët në situatë rruge janë fëmijët të cilët jetojnë dhe/apo punojnë në rrugë dhe ata gëzojnë të drejtat e përcaktuara në Konventë, duke përfshirë të drejtën për jetë, mbijetesë dhe zhvillim, të drejtën për familje, të drejtën për një standard të përshtatshëm jetese, të drejtën për arsimim dhe për të jetuar një jetë pa dhunë në të

gjitha format e saj. Konventa nuk i përmend në mënyrë specifike fëmijët në situatë rruge, por ka dispozita gjithëpërfshirëse që sigurojnë mbrojtjen e këtij grupi të veçantë fëmijësh.



Lojë: Kategorizojë të drejtën!

Vendosni tri zona në anët e ndryshme të një dhome (d.m.th. dy mure anësore dhe muri i pasmë i klasës), tregojuni fëmijëve njëra anë e dhomës është për “Të drejtat e mbrojtjes”, tjetra është për “Të drejtat e ofrimit” dhe muri i pasmë është për “Të drejtat e pjesëmarrjes”. Vendosini kartolinat në qendër të dhomës. Kërkojuni fëmijëve të punojnë si ekip, duke marrë secilën nga e djathta dhe duke vendosur se me cilin mur duhet të shkojë.

Këshilla kryesore: Për ta bërë këtë lojë më tërheqëse, ndani klasën në dy grupe dhe kthejeni këtë lojë në një garë miqësore. Jepini secilit grup 3 minuta për të vendosur sa më shumë të drejta në secilën nga tri fushat që munden dhe atyre do t’u jepet një pikë për çdo të drejtë që e vendosin saktë. Pasi të kenë luajtur të dy grupet, diskutoni për vendosjen e saktë të letrave dhe përse disa të drejta duhet të shkojnë në zona të caktuara.

Cilat janë parimet udhëzuese të KDF-së?

KDF-ja ka katër parime të përgjithshme që udhëzojnë interpretimin e të gjitha neneve të tjera:

1. **Interesat më të mira të fëmijës** (Neni 3.1): Sipas këtij neni, fëmija ka të drejtë që interesat e tij/saj më të mira të merren parasysh si konsideratë parësore në të gjitha çështjet që e ndikojnë fëmijën. Kjo do të thotë, për shembull, që kur një gjyqtare merr një vendim nëse një fëmijë duhet të jetojë me nënën ose babanë e vet, ajo gjyqtare duhet t’i marrë parasysh interesat më të mira të atij fëmije si konsideratë parësore gjatë marrjes së vendimit.
2. **Mosdiskriminimi** (Neni 2): Sipas këtij neni, fëmijët kanë të drejtën për mbrojtje nga diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë. Të gjithë fëmijët duhet të jenë në gjendje t’i gëzojnë të drejtat e tyre pa diskriminim, pavarësisht se cilët janë prindërit e tyre, raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, origjina sociale, varfëria, aftësia e kufizuar ose çdo status tjetër. E drejta për mbrojtje nga diskriminimi kërkon që shtetet të përmbahen nga zbatimi i ligjeve, politikave dhe praktikave që janë direkt ose indirekt diskriminuese. Si shembull, do të ishte shkelje e të drejtave po të kishim një ligj që pengon fëmijët e një grupi të caktuar etnik ta ndjekin shkollën për shkak të përkatësisë së tyre etnike, por gjithashtu do të ishte diskriminuese të kishim një ligj që në mënyrë indirekte i pengon këta fëmijë të shkojnë në shkollë, për shembull duke kërkuar uniforma që janë të papajtueshme me bindjet e tyre në grup.

3. **E drejta për jetë, mbijetesë dhe zhvillim** (Neni 6): Sipas këtij neni, të gjithë fëmijët kanë të drejtë të jetojnë në një shoqëri, komunitet dhe mjedis që mbrojnë të drejtën e tyre për jetë, mbijetesë dhe të gjitha format e zhvillimit. Kjo dispozitë interpretohet gjerësisht për të përfshirë zhvillimin e gjithmbarshëm të fëmijës. Në mënyrë që të jenë në pajtim me këtë të drejtë, shtetet duhet të ndërmarrin veprime për ta mbrojtur atë, duke përfshirë krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për ta mbështetur aktivisht fëmijën për të jetuar dhe për t'u zhvilluar, si dhe për të parandaluar, ndaluar dhe dënuar shkeljen e kësaj të drejte.
4. **E drejta për t'u dëgjuar/për të marrë pjesë** (Neni 12): Ky nen thotë se fëmijët kanë të drejtë t'i shprehin pikëpamjet e tyre për të gjitha çështjet që i prekin ata dhe të cilat merren parasysh në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre. Kjo e drejtë lidhet kryesisht me "pjesëmarrjen", e cila është një "proces i vazhdueshëm, që përfshin shkëmbimin e informacionit dhe dialogun midis fëmijëve dhe të rriturve bazuar në respektin reciprok dhe në të cilin fëmijët mund të mësojnë se si merren parasysh pikëpamjet e tyre dhe ato të të rriturve dhe formësojnë rezultatin e proceseve të tilla".⁸



Lojë: Rango të drejtat tua!

Vendosini të gjitha kartolinat në tavolinë/dysheme dhe kërkojuni fëmijëve të zgjedhin një kartolinë dhe të tregojnë se cilat të drejta janë më të rëndësishme për ta. Nëse ka kohë, kërkojuni fëmijëve të vendosin disa të drejta sipas asaj që është më e rëndësishme për ta.

Pse ka rëndësi KDF-ja?

KDF-ja është e rëndësishme, sepse mbrojnë të drejtat e fëmijëve në jetën e përditshme. Konventa mbulon një gamë të plotë të të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Është e rëndësishme, sepse kur një shtet e ratifikon atë, ai angazhohet ligjërisht t'i zbatojë dhe t'i mbrojë të drejtat e parapara në Konventë. Për shembull, një shtet mund të miratojë ligje për t'i parandaluar shkeljet e të drejtave të fëmijëve. Ata gjithashtu mund të krijojnë mekanizma për t'i mbajtur njerëzit përgjegjës nëse shkelin të drejtat e një fëmije. Duke mbrojtur të drejtat e fëmijëve përmes KDF-së, siguria, gëzimi dhe zhvillimi i fëmijëve mund të mbrohet dhe të përmirësohet.

⁸ Komiteti i KDF-së, Komenti i Përgjithshëm Nr. 12, par. 3.



Loja: Gjeje të drejtën e fëmijëve!

Kërkojuni të gjithë fëmijëve të ngrihen në këmbë, nëse është e mundur. Sigurohuni që zona të jetë e pastër nga objekte të tilla si tavolina/karrige. Vendosini kartolinat në dysHEME dhe lexoni këta skenarë hipotetikë. Kërkojuni fëmijëve që në garë me kohën ta gjejnë kartolinën përkatëse të së drejtës së KDF-së që shkelet në secilin rast.

Shënim: Mund të ketë më shumë se një të drejtë që shkelet në të njëjtën kohë!

Cilat të drejta shkelen atëherë kur ...

Shembulli 1: Fëmijët me pengesa në dëgjim nuk mund të dëgjohen si dëshmitarë, sepse në gjykatën lokale nuk ka përkthyes të gjuhës së shenjave.

Shembulli 2: Të gjithë fëmijët, përfshirë fëmijët myslimanë, shërbejnë me mish derri në qendrën rezidenciale të kujdesit.

Shembulli 3: Ministria e Arsimit nxjerr një ligj të ri për kurrikulën shkollore, por asnjë fëmijë nuk përfshihet në diskutimin e ligjit.

Shembulli 4: Shkollat në qytet janë shumë larg për fëmijët nga zonat rurale dhe nuk ka shkolla lokale në fshatra.

Shembulli 5: Prindërit e një vajze të re po divorcohen dhe ka një mosmarrëveshje se me cilin prind duhet të jetojë vajza. Vendimi merret pa e pyetur vajzën për mendimet e saj.

Çfarë është Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve?

Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, ose “Komiteti”, është një organ ekspertësh të pavarur. Ai u krijua në bazë të Konventës. Detyra e tij është të monitorojë zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe të ofrojë udhëzime për interpretimin dhe zbatimin e saj për qeveritë në mbarë botën. Komiteti gjithashtu monitoron zbatimin e Protokolleve Opsionale të Konventës: Protokollin opsional për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve, dhe Protokollin opsional për përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur. Komiteti mbledhet në Gjenevë dhe përgjithësisht mban tri seanca në vit. Këto sesione përbëhen nga një grup plenar trejavor dhe një grup punues njëjavor para sesionit.

Komisioni përbëhet nga 18 ekspertë të pavarur, gra dhe burra me karakter të lartë moral dhe janë ekspertë të njohur në fushën e të drejtave të njeriut. Ekspertët janë nga shtete të

ndryshme anëmbanë globit. Vendet e ekspertëve aktualë përfshijnë Islandën, Japoninë, Uruguain, Çadin, Afrikën e Jugut dhe Bullgarinë.



Figura 1: Anëtarët e Komitetit të KDF-së, 2021-2023

Më shumë informacion mbi anëtarët e Komitetit dhe punën e tyre mund të gjenden në faqen e internetit Child Rights Connect [këtu](#).

Cili është roli i tyre?⁹

1. **Monitorimi dhe raportimi:** Të gjitha shtetet palë duhet t'i paraqesin një raport fillestar Komitetit dy vjet pas aderimit në Konventë dhe më pas duhet të paraqesin raporte çdo pesë vjet, duke treguar se si e kanë zbatuar Konventën. Komiteti shqyrton çdo raport dhe i adreson shqetësimet dhe rekomandimet e veta shtetit në formën e “vëzhgimeve përmbyllëse”. Për dy protokollat e para opsionale të Konventës, shtetet duhet gjithashtu t'i paraqesin një raport fillestar Komitetit dy vjet pas aderimit. Përpara se Komiteti të takohet me qeverinë e shtetit, OJQ-të, UNICEF-in, agjencitë e OKB-së, fëmijët dhe Ombudsmanët nga vendi përkatës mund t'i dërgojnë një raport

⁹ Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara, Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, OHCHR. Në dispozicion: ohchr.org/en/treaty-bodies/crc, qasur më 5 korrik 2022.

Komitetit duke shpjeguar se sa mirë mendojnë se qeveria i ka mbrojtur të drejtat e fëmijëve.

2. **Pranimi i ankesave:** Komiteti mund t'i shqyrtojë ankesat individuale që pretendojnë shkelje të Konventës dhe dy protokolleve të para opsionale. Çdokush mund të paraqesë një ankesë pranë Komitetit kundër një shteti, me kusht që shteti të jetë palë në KDF dhe ta ketë pranuar kompetencën e Komitetit për t'i shqyrtuar ankesat individuale. Kjo kërkon aderimin në Protokollin Opsional për Procedurën e Komunikimit.¹⁰

Fakt interesant! Një shembull i fundit i përdorimit të “Procedurës së Komunikimit” ishte kur në vitin 2019 aktivistja e klimës dhe mbrojtësja e të drejtave të njeriut Greta Thunberg dhe 15 fëmijë të tjerë të moshave 8 – 17-vjeçare nga e gjithë bota paraqitën një ankesë historike në Komitetin e KDF-së në Gjenevë duke pretenduar se të drejtat e tyre për jetë, shëndet dhe kulturë po cenoheshin nga kriza klimatike.

Ju mund të lexoni më shumë për këtë [këtu](#).

3. **Hetimet:** Komiteti mund të kryejë hetime për pretendimet për shkelje të rënda ose sistematike sipas Konventës nëse merr prova të besueshme. Komiteti mund të kryejë vetëm hetime në lidhje me shtetet palë që e kanë njohur kompetencën e Komitetit për të kryer hetime.
4. **Hartimi i komenteve të përgjithshme:** Komentet e përgjithshme janë interpretimi i Komitetit për përmbajtjen e dispozitave të të drejtave të njeriut. Ato janë rekomandimet e Komitetit për çdo çështje tematike që lidhet me fëmijët, të cilave Komiteti beson se shtetet palë duhet t'u kushtojnë më shumë vëmendje. Deri në muajin shtator 2021, Komiteti ka miratuar 25 komente të përgjithshme. Shembujt përfshijnë komente të përgjithshme mbi mjedisin digjital¹¹, për fëmijët në situatë rruge¹² dhe për të drejtat e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për fëmijët.¹³
5. **Ditët e diskutimit të përgjithshëm:** Komiteti organizon gjithashtu ditë diskutimi të përgjithshëm çdo dy vjet në Gjenevë të Zvicrës për të nxitur të kuptuarit më të thellë të përmbajtjes dhe implikimeve të Konventës në lidhje me nenet ose temat specifike. Këto ditë janë të hapura për përfaqësues të qeverive, organizatave joqeveritare, mekanizmave të OKB-së për të drejtat e njeriut, organeve dhe agjencive të specializuara të OKB-së, institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut, sektorit të biznesit, ekspertëve individualë dhe fëmijëve. Temat e mëparshme kanë përfshirë fëmijët e prindërve të burgosur, të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar dhe të drejtat e fëmijëve indigjenë. Dita e fundit e diskutimit të përgjithshëm, e mbajtur në vitin 2021, ishte mbi të drejtat e fëmijëve dhe kujdesin alternativ.

¹⁰ Lidhja e të Drejtave të Fëmijëve, “Udhëzuesi im i xhepit për raportimin e KDF-së: Një udhëzues shoqëruar për fëmijët që dëshirojnë t'i tregojnë Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve se si respektohen të drejtat e fëmijëve në vendin e tyre”, fq. 20-21. Në dispozicion: <https://childrightsconnect.org/wp-content/uploads/2018/05/crcbookleteng.pdf>, qasur më 14 korrik 2022.

¹¹ KDF, komenti i përgjithshëm Nr.25 (2021).

¹² KDF, komenti i përgjithshëm Nr.21 (2017).

¹³ KDF, komenti i Përgjithshëm Nr.24 (2019).

Diagrami i mëposhtëm paraqet ciklin standard të raportimit të KDF-së, i cili ndodh çdo pesë vjet. Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut të Fëmijëve inkurajohen të marrin pjesë në këtë proces. Disa shtete përdorin gjithashtu një “procedurë raportimi të thjeshtuar” të shkurtuar, e cila përmban më pak hapa, por kryesisht ndjek një proces të ngjashëm të raportimit nga shtetet palë kundrejt një liste çështjesh të përcaktuara nga Komiteti, duke e lejuar Komitetin t’i formojë observimet përfundimtare dhe t’i përcjellë ato.



Figura 2: Diagrami i ciklit të raportimit të KDF-së¹⁴

Më shumë informacione mbi raportimin në Komitet, duke përfshirë udhëzimet zyrtare të raportimit, mund t’i gjeni [këtu](#).

Si mund të marrin pjesë fëmijët?

Sipas nenit 12 të KDF-së, fëmijët kanë të drejtë t’i shprehin pikëpamjet dhe opinionet e tyre për çështjet që i prekin ata dhe kanë të drejtë të dëgjohen. Komiteti merr në konsideratë perspektivën e fëmijëve për çështjet që ndikojnë drejtpërdrejt në ta në komunitetet dhe vendet e tyre për të pasur një kuptim më të plotë të të drejtave të fëmijëve.


Komiteti mirëpret pjesëmarrjen e fëmijëve në mënyrat e mëposhtme:

1. **Procesi i raportimit:** Fëmijët mund të kontribuojnë në shqyrtimin e raporteve të shteteve palë nga Komiteti duke bërë parashtresa dhe duke dhënë prezantime gojore

¹⁴ Lidhja e të Drejtave të Fëmijëve, Raportimi i KDF-së. Në dispozicion: <https://childrightsconnect.org/crc-reporting/>, qasur më 14 korrik 2022.

në grupin e punës para sesionit. Ata gjithashtu mund të marrin pjesë në takime private me anëtarët e Komitetit dhe t'i vëzhgojnë seancat plenare të Komitetit.

2. **Ditët e diskutimit të përgjithshëm:** Fëmijët inkurajohen të marrin pjesë në hartimin dhe planifikimin e Ditëve të Diskutimit, të marrin pjesë dhe të bëjnë parashpresa në Ditët e Diskutimit dhe të organizojnë dhe të marrin pjesë në aktivitetet vijuese.
3. **Komentet e përgjithshme:** Gjatë hartimit të komenteve të përgjithshme, Komiteti do të zhvillojë konsultime me fëmijët dhe do të organizojë sondazhe në internet për t'i mbledhur pikëpamjet e tyre mbi temat e komenteve të përgjithshme.
4. **Ngjarje përkujtimore, vizita brenda vendit dhe ngjarje të tjera:** Komiteti angazhon fëmijët në ngjarje të ndryshme, duke përfshirë përvjetorët e Konventës.



Më shumë informacion se si fëmijët dhe të rinjtë mund të marrin pjesë në proceset e raportimit të KDF-së mund t'i gjeni [këtu](#).



Duart lart!

Cilat çështje mendoni se janë të rëndësishme që Komiteti t'i diskutojë?

Shembuj: Të drejtat dhe liritë civile, dhuna ndaj fëmijëve, mjedisi familjar dhe kujdesi alternativ, paaftësia, shëndeti dhe mirëqenia bazë, arsimi, aktivitetet e kohës së lirë dhe ato kulturore, masat e veçanta të mbrojtjes duke përfshirë edhe refugjatët.¹⁵

Si i mbron KDF-ja të drejtat e fëmijëve kosovarë?

Kosova nuk është palë e KDF-së drejtpërdrejt. Si rezultat i situatës unike politike të Kosovës, Komiteti i KDF-së nuk e shqyrton dhe nuk e vlerëson drejtpërdrejt zbatimin e KDF-së nga vendi ynë. Megjithatë KDF-ja është inkorporuar në të drejtën e brendshme të Kosovës nëpërmjet Kushtetutës së Kosovës.

Kushtetuta thotë se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara nga KDF-ja janë të garantuara edhe me Kushtetutë dhe se KDF-ja është drejtpërdrejt e zbatueshme në Republikën e Kosovës.¹⁶ Kjo do të thotë se të gjitha të drejtat e përfshira në KDF janë të mbrojtura me ligjin kosovar.

Nëse dikush në Kosovë shkel të drejtat e një fëmije kosovar, qeveria duhet të sigurohet që ai të jetë përgjegjës. Për shembull, nëse dikush shkel të drejtat e një fëmije në vendin e punës, të drejtat e KDF-së mund të zbatohen përmes procedurave disiplinore. Një mënyrë tjetër se si mund të zbatohet KDF-ja është nëpërmjet gjykatave kombëtare. Një fëmijë mund të paraqesë një padi në gjykatat kombëtare nëse i shkelen të drejtat dhe gjykata do ta marrë një vendim të drejtë dhe të paanshëm duke përdorur të drejtat e përcaktuara në KDF si bazë ligjore për vendimin e saj.



Duart lart!

A mund të kujtoni ndonjë moment kur keni pasur vështirësi për t'i realizuar të drejtat tuaja?
Çfarë keni bërë për këtë?

Shkruani në blloqet Post-it për veten tuaj dhe më pas diskutoni përgjigjet tuaja, nëse ndiheni rehat duke e bërë këtë, në grupe të vogla prej 10 personash!

¹⁵ Lidhja e të Drejtave të Fëmijëve, "Udhëzuesi im i xhepit për raportimin e KDF-së: Një udhëzues shoqëruar për fëmijët që dëshirojnë t'i tregojnë Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve se si respektohen të drejtat e fëmijëve në vendin e tyre", fq. 40-45. Në dispozicion: <https://childrightsconnect.org/wp-content/uploads/2018/05/crcbookleteng.pdf>, qasur më 14 korrik 2022.

¹⁶ Kushtetuta e Kosovës, neni 22.

PJESA 3.1: RAST STUDIMI MBI NDËSHKIMIN TRUPOR NË KOSOVË

Çfarë është ndëshkimi trupor?

Sipas Kombeve të Bashkuara, ndëshkimi trupor është një formë ndëshkimi ku përdoret forca fizike dhe synon të shkaktojë një farë shkalë dhimbjeje ose shqetësimi, sado të lehtë.¹⁷ Më së shumti përfshin goditjen (“goditje”, “shuplakë”) e fëmijëve me dorë ose me një mjet - kamxhik, shkop, rrip, këpucë, lugë druri etj. Megjithatë mund të përfshijë edhe: shtyrje, kapje, shtrëngim, dridhje, tërheqje flokësh, përdredhje të krahëve, mbyllje të dhimbshme në një hapësirë të kufizuar, detyrimin e një fëmije për të mbajtur një qëndrim fiks për një kohë të gjatë, stërvitje dhe ushtrime të tepërta, gëlltitje të detyruar të substancave të dëmshme ose ekspozim në mjedise të dëmshme.¹⁸

Kjo përfshin ndëshkimin në shtëpi, në komunitet, në sistemin e drejtësisë dhe në shkollë.

Neni 19 i KDF-së u jep të gjithë fëmijëve të drejtën të jenë të lirë nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore. Kjo mbështetet gjithashtu nga nenet 28 (2) dhe 37 të KDF-së dhe u konsolidua në Komentin e Përgjithshëm Nr. 8 (2006) të Komitetit, i cili theksoi të drejtën e fëmijës për t’u mbrojtur nga ndëshkimi trupor dhe format e tjera të trajtimit mizor ose forma degraduese të dënimit. Përmes këtij komenti, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës ka qenë i qartë dhe rekomandon se ndëshkimi trupor ndalohet në të gjitha vendet. Komiteti e sheh këtë formë ndëshkimi si degraduese për fëmijët dhe të dëmshme dhe në vend të kësaj rekomandon forma të tjera jo të dhunshme të disiplinës së fëmijëve. Në mars 2022 Komiteti i OKB-së vuri në dukje gjithashtu se fëmijët me aftësi të kufizuara janë veçanërisht të cenueshëm ndaj kësaj forme dhune.

Ndëshkimi trupor i fëmijëve është i ndaluar në shumë vende të botës. Që nga viti 2022, 65 vende i kanë ndaluar të gjitha format e ndëshkimit trupor. Vendet më të fundit që ndaluan ndëshkimin trupor në vitin 2022 ishin Zambia dhe Mauritius, që të dyja janë në Afrikë.¹⁹


¹⁷ Organizata Botërore e Shëndetësisë, Ndëshkimet trupore dhe shëndeti, 23 nëntor 2021. Në dispozicion: www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/corporal-punishment-and-health, e qasshme 22 mars 2023.

¹⁸ Qendra për Edukimin e Prindërve, Një rast kundër ndëshkimit trupor. Në dispozicion: <https://centerforparentingeducation.org/library-of-articles/discipline-topics/case-corporal-punishment/>, qasur më 22 mars 2023.

¹⁹ Fund dhunës kundër fëmijëve, Përparim. Në dispozicion: <https://endcorporalpunishment.org/countdown/>, qasur më 22 mars 2023.



Në vende të tjera, ndëshkimi trupor është i ndaluar në disa mjedise, por jo në të gjitha mjediset. Për shembull, kjo formë dënimi ende lejohet në disa objekte të paraburgimit për të mitur, por nuk lejohet në shkolla.





Duart lart!

A mendoni se sot në Kosovë lejohet ndëshkimi trupor?

Nëse jo, kur mendoni se u ndalua? (Përgjigje: 27 qershor 2019)

Në Kosovë, ndëshkimi trupor është i ndaluar me ligj që nga qershori i vitit 2019, kur u miratua Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës.²⁰ Ishte vendi i 55-të në botë që ndaloi ndëshkimin trupor.²¹ Ligji për herë të parë ndaloi këtë formë të dhunës ndaj fëmijëve. Neni 38 i ligjit thotë:

“1. Ndëshkimi trupor dhe masat disiplinore, të cilat dëmtojnë dhe dobësojnë dinjitetin njerëzor

të fëmijës, duke përfshirë format e dhunës fizike dhe mendore, si dhe sjellje që e degradojnë, turpërojnë dhe e vënë fëmijën në situatë të dobët, janë të ndaluara në secilin ambient në shtëpi dhe familje, institucione edukativo arsimore, në institucionet e kujdesit, organet e rendit dhe sistemit të drejtësisë, në ambientet e punës dhe komunitetit.

2. Është e ndaluar që një fëmijë të kthehet në subjekt të torturës dhe trajtimit jo njerëzor, jo dinjitoz, ndëshkimit trupor dhe trajtimit degradues nga secili person.

3. Personeli arsimor dhe personeli i lidhur me shkollën nuk duhet të përdorin ndëshkimin trupor si mjet discipline dhe rregulli duhet të bazohet dhe ndërtohet mbi bazën e respektit dhe drejtësisë.

4. Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Inspektorati i Arsimit merr masa disiplinore ndaj personelit arsimor si dhe i raporton organeve të hetuesisë rastet e ndëshkimit trupor të fëmijës, në përputhje me ligjet në fuqi.

5. Ministritë përkatëse sigurojnë nxjerrjen dhe krijimin e programeve të rritjes së ndërgjegjësimit në lidhje me efektet e dëmshme të ndëshkimit trupor dhe të hartojnë dhe krijojnë:

5.1. edukimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me pasojat degraduese të ndëshkimit trupor.

5.2. Programe prindërimi, që promovojnë mënyrat jo të dhunshme të disiplinimit në familje dhe institucione edukativo arsimore dhe në institucione të kujdesit.”

Kjo do të thotë se ndëshkimi trupor është i paligjshëm në të gjitha mjediset, duke përfshirë në shtëpi, në shkollë, nga policia dhe në paraburgimin e të miturve. Gjithashtu është i ndaluar në mjediset e kujdesit alternativ (p.sh. shtëpitë e fëmijëve, shkollat me konvikt etj.) dhe

²⁰ Fund dhunës kundër fëmijëve, Raporti i vendit për Republikën e Kosovës. Në dispozicion: <https://endcorporalpunishment.org/reports-on-every-state-and-territory/republic-of-kosovo/>, qasur më 22 mars 2023.

²¹ Save the Children, Kosova miraton një ndalim të plotë ligjor për ndëshkimin trupor të fëmijëve, 2019. Në dispozicion: https://resourcecentre.savethechildren.net/pdf/kosovo_cplaw.pdf/, qasur më 22 mars 2022.

gjithashtu nuk lejohet të përdoret si dënim për një krim nga një gjyqtar ose nga kushdo në organet e zbatimit të ligjit (sipas Kodit të Drejtësisë për të Miturit 2010, Kodit Penal (2011), Kodit të Procedurës Penale (2012) ose Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (2012)).

Pavarësisht ligjit, shumë njerëz në Kosovë vazhdojnë ta shohin ndëshkimin trupor si pjesë normale të edukimit dhe të disiplinës. Një studim i UNICEF-it në vitin 2013 zbuloi se 71 për qind e fëmijëve kishin përjetuar një formë ndëshkimi trupor. Në vitin 2018 në Polici janë raportuar 244 raste. Një arsye që shkalla e ndëshkimit trupor mbetet e lartë në Kosovë është se shumica e të rriturve (d.m.th. prindërit, mësuesit) janë rritur në një shoqëri që e sheh ndëshkimin trupor si normal.

Megjithatë, qëndrimet ndaj kësaj forme dhune po ndryshojnë. Ndëshkimi trupor gjithnjë e më shumë shihet si i papranueshëm.



Duart lart!

Pse mendoni se ndëshkimi trupor është i keq për fëmijët?

Disa përgjigje mund të përfshijnë (por nuk kufizohen në):

Shkakton dëmtim fizik, ndonjëherë duke rezultuar në dëmtime të rënda, paaftësi afatgjatë ose vdekje;

Shkakton sëmundje mendore, duke përfshirë çrregullime të sjelljes dhe ankthit, depresion, mungesë shprese, vetëvlerësim të ulët, vetëdëmtim dhe përpjekje për vetëvrasje, varësi nga alkooli dhe droga, armiqësi dhe paqëndrueshmëri emocionale, të cilat vazhdojnë deri në moshën madhore;

Ndikon në zhvillimin kognitiv dhe socio-emocional të fëmijëve, veçanërisht në rregullimin emocional dhe aftësitë për zgjidhjen e konflikteve;

Mund të dëmtojë qasjen e fëmijëve në arsimimin e tyre, duke përfshirë rritjen e shkallës së braktisjes së shkollës dhe suksesin më të ulët akademik;

Mund të çojë në rritjen e sjelljes antisociale;

Mund të nënkuptojë rritje të agresivitetit të fëmijët;

Çon në rritjen e pranimi dhe përdorimit të formave të tjera të dhunës; dhe

Dëmton marrëdhëniet familjare.

Disa njerëz kanë pyetje nëse ndalimi i ndëshkimit trupor është gjëja e duhur për të bërë. Këtu janë disa pyetje dhe përgjigje të bëra shpesh nga faqja e internetit “Fundi i dhunës kundër fëmijëve”, të cilat mund të jenë të dobishme kur diskutoni këtë:

P: A nuk janë shumica e njerëzve kundër ndalimit të ndëshkimit trupor?

P: Për këtë çështje – si të tjerat, përfshirë dhunën ndaj grave dhe diskriminimin racor – politikanët duhet të udhëheqin, jo të ndjekin opinionin publik. Theksi duhet të vihet në detyrimin e qeverisë për të siguruar që ligji u siguron fëmijëve, ashtu si të rriturve,

mbrojtje të plotë për dinjitetin e tyre njerëzor. Pothuajse të gjitha vendet që kanë ndaluar të gjitha ndëshkimet trupore e kanë bërë këtë përpara opinionit publik dhe më pas opinionit publik me kalimin e kohës e ka mbështetur ndryshimin. Pas disa vitesh ne do të shikojmë prapa me habi - dhe me turp - në kohën kur konsiderohej e ligjshme dhe e pranueshme të goditeshin fëmijët.

P: Unë u godita si fëmijë dhe nuk më dëmtoi...

P: Askush nga ne nuk e di se si do të kishim dalë nëse prindërit tanë nuk do të na kishin goditur apo poshtëruar kurrë. Dhe shumë njerëz, duke thënë se nuk u bëri dëm, mohojnë lëndimin që përjetuan kur të rriturit më të afërt menduan se mund t'i mësonin vetëm duke shkaktuar dhimbje. Të rriturit që goditnin fëmijët e tyre në emër të disiplinës zakonisht filluan ta bënë këtë, sepse ata vetë goditeshin si fëmijë. Megjithatë hulumtimet tregojnë se ata shpesh ndihen fajtorë për këtë më pas, ata vazhdojnë t'i godasin fëmijët e tyre, veçanërisht kur ata janë në fund të durimit të tyre. Është e kotë t'i fajësosh për këtë gjeneratat e mëparshme, sepse ata vepronin në përputhje me kulturën e kohës. Por është e gabuar t'i rezistosh ndryshimit, sepse kemi frikë të shfaqemi për t'i kritikuar prindërit tanë. Kohët ndryshojnë dhe shoqëritë vazhdojnë. Njohja e fëmijëve si mbajtës të të drejtave kërkon veprim për t'i dhënë fund pranimi social të dhunës ndaj fëmijëve, ashtu siç shoqëritë kanë lëvizur për t'i dhënë fund pranimi të dhunës ndaj grave.

P: Kam dëgjuar të rinj që flasin në mbështetje të ndëshkimit trupor! A nuk duhet t'i dëgjojmë ata?

P: Është e vërtetë që fëmijët ndonjëherë thonë se ndëshkimi fizik është i mirë për ta, se i mëson se si të sillen, apo edhe se kjo tregon se prindërit e tyre i duan. Dhe sigurisht që duhet të dëgjojmë se çfarë thonë të rinjtë. Por të rriturit kanë përgjegjësi jo vetëm të dëgjojnë, por edhe të kuptojnë se çfarë na thonë fëmijët. Tashmë kemi tërhequr vëmendjen për mënyrën se si fëmijët kanë filluar të na tregojnë për lëndimin fizik dhe emocional të shkaktuar nga ndëshkimi trupor. Kur disa fëmijë thonë se kjo është disi e nevojshme dhe e mirë, ata po tregojnë se si janë rritur të rrethuar nga besimi se është normale dhe e drejtë të ndëshkohen fizikisht dhe e kanë përvetësuar vetë këtë besim, duke marrë qëndrimet dhe sjelljet e prindërve të tyre dhe duke racionalizuar ose duke u përpjekur ta kuptojnë lëndimin që kanë përjetuar. Por fëmijët kanë të drejtë të patjetërsueshme për respektimin e dinjitetit të tyre njerëzor dhe të integritetit fizik dhe për mbrojtje të barabartë nga sulmet.

Më shumë informacion dhe përgjigje për pyetjet e shpeshta mund të gjenden [këtu](#).

Çfarë duhet të bëj nëse jam duke përjetuar ndëshkim trupor, ose e kam përjetuar atë në të kaluarën?

Flisni me një të rritur, të cilit i besoni, si p.sh. një mësues ose punonjës social. Ata mund t'ju mbështesin që ta raportoni këtë në Polici dhe t'ju shpjegojnë se cilat janë të drejtat tuaja. Ju gjithashtu mund ta raportoni këtë drejtpërdrejt në një stacion policor ose duke telefonuar Policinë në 192 (celular) ose 92 (telefon fiks).

Nëse keni raportuar dhe askush nuk ndërmerr masa, mund të raportoni edhe në Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës. Për më shumë informacione, ju lutemi shihni seksionin 6 të këtij trajnimi “Si mund të raportoj një shkelje të të drejtave të mia?”

PJESA 3.2: RAST STUDIMI MBI PUNËT FIZIKE TË NDALUARA PËR FËMIJËT NË KOSOVË



Duart lart!

Cilat punë janë të ndaluara për fëmijët?

Shembuj të përgjigjeve: Puna në miniera, puna në ndërtimtari, puna ku përdoren makineri të rënda dhe të rrezikshme, puna me kemikate dhe pesticide, puna gjatë natës etj.

Cilat punë fizike janë të ndaluara për fëmijët?

Punët fizike të ndaluara për fëmijët përfshijnë aktivitete të cilat janë të rrezikshme dhe të dëmshme ose të paarsyeshme për zhvillimin dhe mirëqenien e tyre. Këto ndalime janë për t'i mbrojtur të drejtat dhe për sigurinë e fëmijëve. Në shumicën e vendeve, ligjet dhe rregulloret specifike përcaktojnë se cilat punë janë të ndaluara për fëmijët.

Këtu janë disa prej punëve fizike të ndaluara për fëmijët:

- **Punët të cilat janë të rrezikshme ose të dëmshme për shëndetin e tyre:** kjo përfshin punët që përbëjnë rrezik për shëndetin dhe sigurinë fizike të fëmijëve, si: punët në kushte të rrezikshme për aksidente ose kontaminim kimik.
- **Punët që ndikojnë negativisht në arsimimin e tyre:** fëmijët kanë të drejtën për arsimim dhe punët e rënda fizike mund ta pengojnë këtë të drejtë.
- **Punët të cilat pengojnë zhvillimin e tyre fizik dhe emocional:** puna e rëndë fizike mund të pengojë zhvillimin e duhur të muskujve, kockave dhe sistemeve të tjera të trupit të fëmijëve.
- **Punët të cilat janë në kundërshtim me normat shoqërore dhe kulturore:** disa punë mund të konsiderohen si të papërshtatshme ose të pakuptueshme në kontekstin e një shoqërie të caktuar.

Punët fizike të ndaluara për fëmijët janë pjesë e përpjekjeve për të siguruar që ata të rriten në një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur dhe ta kenë mundësinë për ta zhvilluar potencialin e tyre në mënyrë të shëndetshme dhe pozitive.

Çka thotë ligji?

Në Kosovë, ligji e ndalon punën e fëmijëve në moshë të re me qëllim për t'i mbrojtur të drejtat dhe mirëqenien e tyre, duke u nisur nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, që në mënyrë të qartë mbron të drejtat e fëmijëve, përfshirë “Të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre” dhe mbrojtjen nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.²² Pasuar nga Ligji Punës, i cili përcakton kushtet e punës të personave nën moshën minimale të lejuar për të punuar²³; dhe Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili përcakton se fëmijët janë të mbrojtur nga çdo lloj dhune, përfshirë punën e paligjshme dhe të rrezikshme. Përpos ligjeve, edhe Konventa e të Drejtave të Fëmijës (KDF) dhe Konventa Ndërkombëtare për Fëmijët në Punë (ILO Convention No. 182) ndalojnë punën e rrezikshme të fëmijëve.

PJESA 4: SI MBROHEN TË DREJTAT E FËMIJËVE KOSOVARË NË NIVEL REGIONAL DHE KOMBËTAR?

Të drejtat e fëmijëve në kontekstin rajonal

Këshilli i Evropës (KiE) është organizata kryesore ndërkombëtare në rajon. Ajo ka 46 anëtarë që punojnë për t'i mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit në të gjithë Evropën.²⁴ Si pjesë e KiE-së, të gjitha shtetet anëtare duhet ta ratifikojnë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), e cila synon t'i mbrojë të drejtat e njeriut dhe liritë politike në shtetet anëtare.²⁵ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut trajton çështjet në lidhje me zbatimin ose interpretimin e Konventës.

Në Kosovë, Këshilli i Evropës (veçanërisht zyra e tyre e dedikuar në Prishtinë) ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe koordinimin e institucioneve kyçe përmes procesit të reformës demokratike.²⁶ Në maj të vitit 2022, Kosova ka aplikuar për anëtarësim zyrtar në



²² Neni

²³ Ligji

²⁴ Këshilli i Evropës, 4 korrik 2022.

²⁵ Shtetet anëtare të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, institucioneve kyçe përmes procesit të reformës demokratike.

²⁶ Këshilli i Evropës, <https://www.coe.int/en/web/european-court-of-human-rights>

4 korrik

rë të një

Këshillin e Evropës.

Figura 3: Foto e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, Francë

Bashkimi Evropian (BE) është një aleancë politike dhe ekonomike e 27 vendeve me bazë në Evropë. BE-ja promovon vlerat demokratike dhe ndan një treg të vetëm, duke e bërë atë një nga blloqet më të mëdha tregtare në botë. Kosova aktualisht po konsiderohet si kandidatë potenciale për anëtarësim në BE. Si pjesë e këtij procesi, Kosova ka hyrë në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, e cila synon të prezantojë reforma demokratike dhe ekonomike, për ta sjellë Kosovën në harmonizim më të madh me shtetet e tjera anëtare të BE-së.²⁷

Pavarësisht se ende nuk është anëtare e KiE-së apo e BE-së, ligjet rajonale të zbatuara nga këto organizata kanë ndikuar jashtëzakonisht në të drejtat e fëmijëve në Kosovë. Tabela e mëposhtme rendit disa nga instrumentet legjislative evropiane më me ndikim në lidhje me fëmijët:

Ligji	Qëllimi
Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut) ²⁸	• Synon t'i mbrojë të drejtat e njeriut dhe liritë politike të njerëzve që jetojnë në Shtetet Anëtare. • Shkeljet e të drejtave të Konventës mund të referohen në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
Karta Sociale Evropiane ²⁹	• Garanton të drejtat sociale dhe ekonomike (p.sh. punësimin, strehimin, shëndetin, arsimin, mbrojtjen sociale dhe mirëqenien). • Frymëzim për Kartën e BE-së për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.
Konventa Evropiane për Shtetësinë ³⁰	• Zgjeron numrin e fëmijëve të cilëve mund t'u jepet shtetësia, duke ndihmuar që të gjithë fëmijët të kenë qasje në ligjet dhe në shërbimet kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve.
Konventa Evropiane (Konventa e Lanzarotës) për Mbrojtjen e Fëmijëve Kundër Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual ³¹	• Detyron shtetet palë t'i kriminalizojnë të gjitha llojet e veprave seksuale ndaj fëmijëve. • Komiteti i Lanzarotës është organi që lehtëson bashkëpunimin midis shteteve në trajtimin e dhunës seksuale dhe siguron zbatimin e Konventës në të gjitha shtetet anëtare.

²⁷ Këshilli i Evropës, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) nënshkruar ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Në dispozicion: <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/27/kosovo-eu-stabilisation-association-agreement/#:~:text=The%20SAA%20will%20establish%20an,of%20European%20standards%20by%20Kosovo>, qasur më 4 korrik 2022.

²⁸ Bashkimi Evropian, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në dispozicion: <https://www.echr.coe.int/pages/home.aspx?p=basictexts>, qasur më 10 korrik 2022.

²⁹ Këshilli i Evropës, Karta Sociale Evropiane. Në dispozicion: <https://www.coe.int/en/web/european-social-charter>, qasur më 12 korrik 2022.

³⁰ Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Shtetësinë. Në dispozicion: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treaty-num=166>, qasur më 12 korrik 2022.

³¹ Këshilli i Evropës, Konventa Lanzarote. Në dispozicion: <https://www.coe.int/en/web/children/lanzarote-convention>, qasur 12 korrik 2022.

Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore të Fëmijëve ³²	• Përmbledh një sërë rekomandimesh dhe udhëzimesh për profesionistët që punojnë me fëmijët që ndërveprojnë me sistemin e drejtësisë, qofshin viktimë, kryerës apo dëshmitarë.
Rregullat evropiane për shkelësit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve ose masave ³³	• Qëllimi i rregullave është t'i mbrojnë të drejtat e kryerësve të mitur dhe ta promovojnë mirëqenien e tyre fizike, mendore dhe sociale nëse ata bëhen subjekt i sanksioneve, masave ose çdo forme privimi nga liria. • Thekson nevojën që parimi i “interesit më të mirë” të zbatohet kur kemi të bëjmë me kryerësit e mitur.

Të drejtat e fëmijëve në kontekstin kombëtar

Siç u përmend më herët në Seksionin 2 kur diskutuam se “Kush i mbrojnë të drejtat tona?”, shumë organe dhe grupe të ndryshme njerëzish janë përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në Kosovë, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar rregullohet përmes disa ligjeve kryesore, politikave dhe organeve përgjegjëse, të cilat të gjithë qytetarët e Kosovës duhet t'i respektojnë.

Për shembull, **Kushtetuta e Republikës së Kosovës** është akti më i lartë juridik në vend. Kushtetuta mbrojnë të drejtat e fëmijëve duke zbatuar drejtpërdrejt KDF-në dhe duke i vendosur detyrime ligjore shtetit për t'i respektuar dhe përmbushur të drejtat e fëmijëve.³⁴ Të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë përfshijnë, por nuk kufizohen në: “E Drejta për Jetën” (Neni 25); “Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar” (Neni 27); “E Drejta për Arsimim” (Neni 47); “Liria e Fesë” (Neni 38), dhe Neni 50 – “Të Drejtat e Fëmijës”, i cili trajton në mënyrë eksplicite të drejtat e fëmijëve. Të gjitha organet qeveritare, organizatat dhe njerëzit në Kosovë duhet t'i përmbahen Kushtetutës për të ndihmuar që ajo të zbatohet. Gjykata Kushtetuese është organi përgjegjës kryesor për sigurimin e zbatimit të saj.

Strategjia e Kosovës për të Drejtat e Fëmijës 2019-2023 përshkruan objektivat strategjike të qeverisë për promovimin e të drejtave të fëmijëve. Këto përfshijnë përmirësimin e qeverisjes në nivel kombëtar dhe lokal, përfshirjen e fëmijëve në vendimarrje dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve. Brenda kësaj strategjie shumë organe dhe organizata qeveritare në nivel kombëtar dhe lokal luajnë rol në realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe përmbushjen e pesë objektivave strategjike të përcaktuara në strategji.

Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare përshkruan organet që janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe kujdesit alternativ për fëmijët në Kosovë. Institucioni kryesor është **Departamenti i Mirëqenies Sociale (DMS)**, i cili është pjesë e **Ministritë së Drejtësisë**. DMS-ja luan rol kryesor në zhvillimin e politikave dhe koordinimin e ofrimit të shërbimeve sociale.

³² Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore për fëmijët. Në dispozicion: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016804b2cf3, qasur më 12 korrik 2022.

³³ Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, Rregullat Evropiane për shkelësit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve ose masave. Në dispozicion: <https://www.refworld.org/pdfid/4a7058c02.pdf>, qasur më 12 korrik 2022.

³⁴ Institucioni i Avokatit të Popullit, Raporti Vjetor 2021 Nr.21, Prishtinë, 2022, fq. 47.

Qendra për Punë Sociale (QPS) është organi që ofron shërbime profesionale sociale dhe familjare në nivel komunal për njerëzit dhe familjet në nevojë, përfshirë edhe fëmijët.³⁵ Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe draft Ligji për Financat e Pushtetit Lokal synojnë të decentralizojnë më tej dhe të zhvillojnë ofrimin e shërbimeve sociale.

Një ligj i rëndësishëm është edhe Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF), i cili hyri në fuqi në korrik 2020. LMF-ja krijoi një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse që mbrohet drejtpërdrejt fëmijët nga të gjitha format e abuzimit dhe shfrytëzimit.³⁶ Përpara LMF-së, sistemi i mbrojtjes së fëmijëve ishte i fragmentuar dhe kishte probleme të konsiderueshme të koordinimit, kështu që LMF-ja ka qenë jetike në krijimin e një sistemi të vetëm dhe koherent. LMF-ja ka qenë gjithashtu e rëndësishme në zgjerimin e mbrojtjes së fëmijëve për t'i mbuluar ata që nuk kanë qenë të përfshirë sipas ligjeve të mëparshme, si: fëmijët e zhvendosur brenda vendit, pa shtetësi, refugjatë dhe azilkërkues.

Tabela më poshtë përshkruan të drejtat e tjera kryesore të fëmijëve që mbrohen me ligjin kombëtar në Kosovë:

E drejta	Mbrojtja e ofruar ³⁷
E Drejta për Shëndet dhe Shërbime të Kujdesit Shëndetësor	• Kushtetuta njeh të drejtën e çdo personi për integritet fizik dhe psikologjik. • Neni 4, Ligji për Shëndetësi - të gjithë qytetarët dhe banorët kanë të drejtë për qasje të barabartë në kujdesin shëndetësor. • Megjithatë, ka qasje të pabarabartë dhe rezultate më të ulëta shëndetësore për fëmijët romë, ashkalinj dhe egjiptianë,³⁸ si dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.³⁹ Ky problem vetëm sa është përkeqësuar për shkak të pandemisë.
E Drejta për Arsim	• Kushtetuta: “Çdo person ka të drejtën e arsimit bazik falas.” • Neni 125, Ligji për Familjen: “Fëmijët kanë të drejtën e shkollimit fillore falas, të marrjes së informimit për profesione të ndryshme si dhe për shkollat që ekzistojnë.” • Megjithatë, ka pabarazi në arritjet arsimore dhe çështje të qasjes për fëmijët me aftësi të kufizuara, ata rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe ata që jetojnë në familje rurale ose të varfra.⁴⁰

³⁵ Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët, Korniza Ligjore për të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë: Një studim i përputhshmërisë së legjislacionit ekzistues me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, UNICEF, Prishtinë, prill 2014.

³⁶ Programi i Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët në Kosovë, Gjendja e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë, UNICEF, shtator 2021. Në dispozicion: <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/2646/file/English-2021.pdf>, qasur më 7 korrik 2022.

³⁷ Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët, Korniza Ligjore për të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë: Një studim i përputhshmërisë së legjislacionit ekzistues me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, UNICEF, Prishtinë, prill 2014. Në dispozicion: <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/reports/legal-framework-child-rights-kosovo>, qasur më 4 qershor 2022.

³⁸ Programi i Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët në Kosovë, Gjendja e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë, UNICEF, shtator 2021. Në dispozicion: <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/2646/file/English-2021.pdf>, qasur më 7 korrik 2022.

³⁹ Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, Raporti Vjetor 2021 Nr.21, Prishtinë, 2022, fq. 53.

⁴⁰ Programi i Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët në Kosovë, Gjendja e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë, UNICEF, shtator 2021. Në dispozicion: <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/2646/file/English-2021.pdf>, qasur më 7 korrik 2022.

Drejtësia për të Mitur	• Kodi i Drejtësisë për të Mitur - përshkruan mbrojtjen e posaçme që u ofrohet fëmijëve, kryerës të veprës dhe viktimë, duke përfshirë: - “interesi më i mirë” i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese gjatë procesit penal; - ndaj kundërvajtësve të mitur vendosen masat e diversitetit dhe ato edukative aty ku është e përshtatshme; - përcakton moshën minimale të ndjekjes penale si 14 vjeç, në përputhje me standardet ndërkombëtare.
Të Drejtat Politike	• Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë - mbështet qasjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe përshtat përgjegjësitë e organeve qeverisëse për të lehtësuar më mirë pjesëmarrjen e të rinjve.⁴¹ • Megjithatë, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe ata nga komunitetet rom, egjiptian dhe ashkali përjetojnë barriera të shumta dhe më pak mundësi për pjesëmarrje.⁴²

Një sërë organesh dhe organizatash qeveritare kanë përgjegjësi për zbatimin e këtyre ligjeve në Kosovë. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen në Policinë, gjykatat, ministritë dhe departamentet kryesore të qeverisë dhe autoritetet komunale. Secili luan rol të ndryshëm, por të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.



Duart lart!

Sipas mendimit tuaj, a ka ndonjë të drejtë tjetër që dëshironi ta mbrojë ligji kosovar?

⁴¹Qëndresa Ibra-Zariqi, Përmbledhje e Ligjeve për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Republikën e Kosovës, Projekti Mario dhe TDH, janar 2012. Në dispozicion: <https://childhub.org/en/child-protection-online-library/summary-laws-protect-childrens-rights-republic-kosovo>, qasur më 14 korrik 2022.

⁴² Programi i Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët në Kosovë, Gjendja e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë, UNICEF, shtator 2021. Në dispozicion: <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/2646/file/English-2021.pdf>, qasur më 7 korrik 2022.

PJESA 5: ÇKA ËSHTË INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT TË KOSOVËS?

Çka është Ombudspersoni apo Avokati i Popullit?

Fjala “ombudsperson” fillimisht kishte kuptimin: *“Diçka e ngjashme me ambasadorin; një person ose zyrë e krijuar për t’i mbrojtur të drejtat e qytetarëve individualë.”*⁴³ Një ombudsperson caktohet për t’i shqyrtuar ankesat për çështje specifike, të tilla si ankesat kundër kompanive të energjisë elektrike, ankesat për linjat ajrore, ankesat kundër diskriminimit dhe ankesat kundër autoriteteve publike. Ombudspersoni zakonisht emërohet nga Parlamenti, dhe është i pavarur.

Çka është Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës?

Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës (IAP) është i përcaktuar në Kushtetutën e Kosovës.⁴⁴ Roli dhe kompetencat e tij janë të parapara në Kushtetutën e Kosovës dhe në Ligjin për Avokatin e Popullit (LAP).⁴⁵ Roli i tij është që t’i mbikëqyrë dhe t’i mbrojë të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.⁴⁶

IAP-ja mbështet trajtimin e barabartë pa diskriminim⁴⁷ mbi baza të mbrojtura me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.⁴⁸

IAP-ja është e pavarur, e paanshme, konfidenciale, profesionale dhe e përkushtuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nuk pranon udhëzime apo ndërhyrje nga autoritetet e tjera shtetërore.⁴⁹ Për të lejuar që IAP-ja ta kryejë funksionin e vet, autoritetet e tjera shtetërore duhet t’u përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i japin çdo informacion që kërkon.⁵⁰

IAP-ja përbëhet nga Avokati i Popullit, pesë zëvendës të Avokatit të Popullit dhe nga stafi i institucionit.⁵¹ IAP-ja ka një departament të veçantë, i cili është përgjegjës për trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të fëmijëve.

Avokat i Popullit aktualisht është z. Naim Qelaj. Ai është jurist dhe ka punuar më parë për Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe si Koordinator Kombëtar kundër Dhunës në Familje, për dy vjet, gjatë mandatit të tij si zëvendësministër i Drejtësisë (2018-2020).⁵² Ai u zgjodh më 28 shtator 2020 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për të shërbyer për pesë vjet si Avokat i Popullit.

⁴³ Rrjeti Evropian i Ombudspersonëve për Fëmijë, Pyetje & Përgjigje. Në dispozicion: https://enoc.eu/?page_id=17, qasur më 6 korrik 2022.

⁴⁴ Kushtetuta e Kosovës, Kapitulli XII.

⁴⁵ Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, 2015.

⁴⁶ Kushtetuta e Kosovës, Neni 132(1), dhe Ligji për Avokatin e Popullit (2015), neni 1.

⁴⁷ Ligji për Avokatin e Popullit (2015), neni 1.

⁴⁸ Ligji 05/L -021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, 2015.

⁴⁹ Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi (2015), neni 132(2).

⁵⁰ Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi (2015), neni 132(3).

⁵¹ Ligji për Avokatin e Popullit (2015), neni 5.

⁵² Institucioni i Avokatit të Popullit, Ombudspersoni. Në dispozicion në: <https://oik-rks.org/en/ombudsman/>, qasur më 12 korrik 2022.




Figura 4: Foto e Avokatit të Popullit aktual z. Naim Qelaj.

IAP-ja synon të mbetet transparente dhe e përgjegjshme duke ia bërë të qartë publikut se cilat janë funksionet e veta dhe si e përmbush mandatin e vet.⁵³ IAP-ja synon gjithashtu ta rrisë besimin midis qytetarëve dhe qeverisë duke lehtësuar një marrëdhënie koherente midis të dyja palëve dhe duke inkurajuar qytetarët që të marrin pjesë në punën e institucionit.⁵⁴

⁵³ Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës. Rreth nesh, në dispozicion në: <https://oik-rks.org/en/about-us/>, qasur më 6 korrik 2022.

⁵⁴ Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës. Rreth nesh, në dispozicion në: <https://oik-rks.org/en/about-us/>, qasur më 6 korrik 2022.

Çfarë bën Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës?



IAP-ja ka shumë funksione të ndryshme për t'i mbrojtur dhe promovuar të drejtat e të gjithë kosovarëve, duke përfshirë:

- **Hetimin:** IAP-ja ka kompetencën për t'i hetuar shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut, sipas Kushtetutës dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Këto hetime mund të jenë në përgjigje të një ankese ose me iniciativën e vet (ex officio), nëse ka arsye për të besuar se autoritetet kanë shkelur të drejtat e njeriut. Kur IAP-ja ndërmerr një hetim që konstaton se ka ndodhur një shkelje, mund të kërkojë informata shtesë dhe t'u japë rekomandime autoriteteve përgjegjëse. Avokati i Popullit mund të konstatojë se praktika ose situata e përgjithshme shkel të drejtat e njeriut. Në këto raste, IAP-ja mund të përpilojë një raport të posaçëm për përmirësimin e situatës dhe t'i bëjë rekomandime Kuvendit, Qeverisë dhe autoriteteve të tjera kompetente të Republikës së Kosovës.
- **Gjyqësorin:** IAP-ja është institucion i ndarë nga gjykatat. Megjithatë, ai mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, të bëjë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor dhe të paraqitet në cilësinë e *mikut të gjykatës* në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.⁵⁵ Ai gjithashtu mund t'i ushtrojë kompetencat e veta nëpërmjet ndërmjetësimit dhe pajtimit.⁵⁶
- **Mekanizmin Kombëtar Parandalues (MKP):** Avokati i Popullit gjithashtu vepron si MKP kundër torturës dhe trajtimeve dhe dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe

⁵⁵ Ligji për Avokatin e Popullit (2015), nenet 16(8)-(10).

⁵⁶ Ligji për Avokatin e Popullit (2015), neni 16(11).

poshtëruese.⁵⁷ Kjo përfshin vizita të rregullta dhe të paparalajmëruara në vendet e privimit nga liria, siç janë burgjet.⁵⁸

- **Raportimin:** Avokati i Popullit e paraqet raportin vjetor në Kuvendin e Republikës së Kosovës për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut, barazisë dhe të diskriminimit në Kosovë.⁵⁹
- **Këshillimin:** Avokati i Popullit mund t'i këshillojë dhe t'i japë rekomandime çdo personi fizik ose juridik në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut dhe mund t'i këshillojë institucionet shtetërore për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut.⁶⁰



Shiko!

Avokati i Popullit aktual z. Naim Qelaj ka bërë një video të shkurtër duke shpjeguar punën e zyrës së tij dhe rolin e tij në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve kosovarë. Nëse keni qasje në projektor dhe laptop, ju lutemi shfaqeni atë. Është në dispozicion në prezantimin PowerPoint.

Cili është roli i IAP-së në mbrojtjen e fëmijëve?

IAP-ja është e obliguar ligjërisht të miratojë procedura specifike për pranimin dhe trajtimin e ankesave nga fëmijët.⁶¹ Kjo përfshin krijimin e një ekipi të specializuar për të drejtat e fëmijëve dhe zhvillimin e një programi që fëmijët të mësojnë për të drejtat e tyre dhe rolin e IAP-së në mbrojtjen e tyre. Ata që e mbajnë këtë trajnim sot janë nga IAP-ja dhe punojnë çdo ditë për t'i trajtuar rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut, duke përfshirë rastet e fëmijëve.

IAP-ja ka një procedurë të veçantë për ankesat e parashtruara nga fëmijët apo që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve.⁶² Ndikimi i parimeve udhëzuese të KDF-së është i qartë nga parimet e përgjithshme që mbështesin Rregulloren, të cilat u referohen interesave më të mira të fëmijës, mosdiskriminimit, së drejtës për të mbijetuar dhe zhvilluar dhe të së drejtës për t'u dëgjuar.⁶³

⁵⁷ Ligji për Avokatin e Popullit (2015), neni 17.

⁵⁸ Ligji për Avokatin e Popullit (2015), neni 18(7).

⁵⁹ Kushtetuta e Kosovës, neni 135(1), dhe Ligji për Avokatin e Popullit (2015), neni 29.

⁶⁰ Ligji për Avokatin e Popullit (2015), neni 18(2)-(3).

⁶¹ Ligji për Avokatin e Popullit (2015), neni 18.

⁶² Procedurat e veçanta për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave të paraqitura nga fëmijët ose ankesave në lidhje me të drejtat e fëmijëve, Rregullorja (OI) nr. 01/2019, 2019.

⁶³ Procedurat e veçanta për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave të paraqitura nga fëmijët ose ankesave në lidhje me të drejtat e fëmijëve, Rregullorja (OI) nr. 01/2019, 2019, neni 3.

PJESA 6: SI TA RAPORTOJ SHKELJEN E TË DREJTAVE TË MIA?

Si të bëni një ankesë tek Avokati i Popullit?

Procedura për paraqitjen e ankesave pranë IAP-së është pa pagesë. Ankesat mund të bëhen në Zyrën Qendrore të IAP-së dhe në zyrat rajonale.

Procedura për paraqitjen e ankesave nga fëmijët përcaktohet në Rregulloren për Procedurat e Veçanta të Pranimi, Trajtimin dhe Adresimin të Ankesave të Parashtruara nga Fëmijët ose Ankesave që lidhen me të Drejtat e Fëmijëve.

1. Parashtrimi i ankesës:⁶⁴

- a. **Kush?** Çdo fëmijë ose përfaqësuesi i tij (p.sh. prindi, kujdestari, avokati) mund të paraqesë një ankesë duke pretenduar se të drejtat e fëmijës janë shkelur nga autoritetet publike.
- b. **Çka?** Ankesa duhet t'i përfshijë të dhënat personale të ankuesit, informacionin për ta identifikuar dhe kontaktuar fëmijën në fjalë, një përshkrim të shkurtër të rastit, veprimet ose mosveprimet e autoriteteve që kanë shkelur të drejtën e fëmijës dhe një deklaratë nëse e ka ushtruar apo jo të drejtën për mjetet juridike.
- c. **Ku?** Ankesa mund të bëhet në zyrën qendrore apo rajonale të IAP-së, me e-mail, postë, telefonata zyrtare, në kuti ankesash ose përmes rrjeteve sociale të IAP-së.

2. Pranimi dhe regjistrimi:⁶⁵ Çdo ankesë më pas regjistrohet me një numër unik identifikimi. Nëse ankesa nuk përmban informacionin e duhur, stafi mund ta ndihmojë ankuesin ta plotësojë informacionin e nevojshëm dhe t'i përfshijë dokumentet e kërkuara.

3. Vlerësimi paraprak:⁶⁶ DMDF-ja do ta vlerësojë ankesën duke përcaktuar identitetin e ankuesit, të drejtën e shkelur të fëmijës, organin përgjegjës dhe nëse ankesa bie në kompetencën e IAP-së. DMDF-ja do ta marrë parasysh mendimin e fëmijës dhe do ta dëgjojë atë.

4. Refuzimi apo hedhja poshtë e ankesës:⁶⁷ Ankesa mund të hidhet poshtë nga zëvendësi i Avokatit të Popullit: nëse është e pamundur të identifikohet ankuesi; rezultatet e veprimit ose mosveprimit janë joreale; nuk ka shenja të shkeljes të së drejtës së fëmijës; rrethanave të pavërtetuara; ose ankesa nuk përmbush kërkesat formale për procedura të mëtejshme. Zëvendësi i Avokatit të Popullit mund ta

⁶⁴ Procedurat e Veçanta për Pranimin, Trajtimin dhe Adresimin e Ankesave të Paraqitura nga Fëmijët ose Ankesave në lidhje me Të drejtat e Fëmijëve, Rregullorja (OI) nr. 01/2019, 2019, neni 7.

⁶⁵ Procedurat e Veçanta për Pranimin, Trajtimin dhe Adresimin e Ankesave të Paraqitura nga Fëmijët ose Ankesave në lidhje me Të drejtat e Fëmijëve, Rregullorja (OI) nr. 01/2019, 2019, neni 8.

⁶⁶ Procedurat e Veçanta për Pranimin, Trajtimin dhe Adresimin e Ankesave të Paraqitura nga Fëmijët ose Ankesave në lidhje me Të drejtat e Fëmijëve, Rregullorja (OI) nr. 01/2019, 2019, neni 9.

⁶⁷ Procedurat e Veçanta për Pranimin, Trajtimin dhe Adresimin e Ankesave të Paraqitura nga Fëmijët ose Ankesave në lidhje me Të drejtat e Fëmijëve, Rregullorja (OI) nr. 01/2019, 2019, neni 10.

refuzojë ankesën: nëse nuk janë shteruar të gjitha mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme; kur procedurat janë duke u zhvilluar në organet e tjera kompetente; kur kërkesa nuk është kompletuar as pas kërkesave të Avokatit të Popullit; ose kur është e qartë se të drejtat nuk janë shkelur.⁶⁸

5. **Hetimi:**⁶⁹ Pasi vendoset se ankesa është e pranueshme, caktohet një zyrtar për ta trajtuar rastin. Zyrtari përgjegjës do ta mbledhë informacionin që i nevojitet për ta trajtuar ankesën. Fëmija do të ketë të drejtë t'i shprehë mendimet e tij në lidhje me trajtimin e ankesës. Nëse fëmija duhet të intervistohet, intervista do të kryhet dhe asistohet nga një psikolog profesionist. Çdo informacion që merret nga fëmija do të përfshihet në dosjen e ankesës.
6. **Përfundimi dhe përmbyllja e hetimit:**⁷⁰ Zyrtari përgjegjës do ta ndërpresë hetimin: nëse rikthehet e drejta e shkelur; ankuesi tërheq ankesën; ose rasti është zgjidhur ndryshe në pajtim me kërkesën e ankuesit. Nëse zyrtari përgjegjës vlerëson se ka shkelje të të drejtave të fëmijës, varësisht nga rasti, ai mund të përgatisë një letër rekomandimi. Letra do t'i dërgohet institucionit përgjegjës dhe ankuesit.

Detajet për kontakt të Avokatit të Popullit

Ankesat mund të bëhen nëpërmjet telefonit duke telefonuar Zyrën e Avokatit të Popullit, në numrin 0800 15555. Telefonata është falas.

Ju gjithashtu mund ta raportoni rastin duke plotësuar një formular të thjeshtë në faqen kryesore të internetit të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës. Faqja në internet është: <https://oik-rks.org/en/>. Faqja e internetit është në dispozicion në shqip, serbisht dhe anglisht.

Ju gjithashtu mund t'i dërgoni e-mail Zyrës së Avokatit të Popullit, në info.oik@oik-rks.org ose të dërgoni ankesë në adresa e zyrës së IAP-së:

Institucioni i Avokatit të Popullit
Rr. "MIGJENI", nr. 21
10000 Prishtinë, KOSOVE

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me procesin, faqja e internetit ka gjithashtu një faqe të dobishme FAQ [këtu](#).

Çka ndodh pasi të paraqitet ankesa dhe Avokati i Popullit konstaton se ka pasur shkelje të të drejtave të fëmijës?

Nëse zyrtari përgjegjës vlerëson se ka shkelje të të drejtave të fëmijëve, varësisht nga rasti, ai mund të përgatisë një letër rekomandimi. Letra do t'i dërgohet institucionit përgjegjës.

Më pas, zyrtari përgjegjës do të monitorojë se si po zbatohen rekomandimet nga letër rekomandimi duke kërkuar informacion nga autoriteti publik përgjegjës se si e ka adresuar ankesën. Nëse zyrtari përgjegjës konsideron se përgjigjja e autoritetit publik është e

⁶⁸ Ligji për Avokatin e Popullit (2015), neni 22.

⁶⁹ Rregullorja për ankesat e paraqitura nga fëmijët, nenet 11-13.

⁷⁰ Rregullorja për ankesat e paraqitura nga fëmijët, neni 14.

pamjaftueshme, ai mund të propozojë dërgimin e çështjes tek autoriteti më i lartë publik në hierarki.⁷¹

Përfundimisht, si mjet i fundit nëse autoriteti publik nuk ndërmerri masat e duhura brenda afatit, IAP-ja do ta informojë Kuvendin për situatën.⁷²

Është e rëndësishme t'u bëhet e qartë fëmijëve se Avokati i Popullit nuk ka kompetenca të pakufizuara. Ligji përcakton përgjigjet e mësipërme që IAP-ja mund të marrë kur konstaton se të drejtat e fëmijës janë shkelur. IAP-ja nuk mund të vendosë sanksione të tjera siç mund të bëjnë disa institucione të tjera kombëtare të të drejtave të njeriut në mbarë botën, të tilla si: fillimi i një çështjeje gjyqësore në emër të fëmijës; detyrimi që një fëmijë ose familja e tyre të marrin kompensim ose të garantojnë reformën ligjore. Roli i IAP-së është të rekomandojë dhe t'i bëjë presion qeverisë që t'i përmbahet legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve.



Lojë: Çka ndodh nëse bëj një ankesë?

Në anën e pasme të letrës A1 që fëmijët kanë përdorur më herët për të bërë harta mendore, mund t'i vizatojnë tani hapat kyç për të bërë një ankesë në zyrën e Avokatit të Popullit, duke filluar që nga momenti kur të drejtat e tyre janë shkelur e deri në atë që Avokati i Popullit mund të bëjë nëse ankesa pranohet. Diskutoni me fëmijët se çfarë është dhe çfarë nuk është e mundur të bëjë Avokati i Popullit, sipas ligjit.

Më poshtë është një shembull i një ankesë të mëparshme të bërë nga një fëmijë drejtuar Avokatit të Popullit dhe çfarë ka ndodhur me rastin e tij. Emri i fëmijës është ndryshuar për ta mbrojtur identitetin e fëmijës dhe për të siguruar që ankesa e tij të mbetet konfidenciale.

Rast studimi: Rast i hetuar nga zyra e Avokatit të Popullit

Në vitin 2021, IAP-ja – Departamenti i të Drejtave të Fëmijëve hapi një rast ex officio⁷³ në lidhje me të drejtat e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore për të pasur një ekip vlerësimi profesional dhe mbështetës në dispozicion në shkollë për ta mbështetur mësimin dhe përfshirjen e tyre në klasë. Rasti ndoqi këtë afat kohor:

Hapi 1

Grupi i fëmijëve në një vizitë në shkollë e ngriti këtë çështje në vëmendje të ekipit të IAP-së.



⁷¹ Rregullorja për ankesat e paraqitura nga fëmijët, neni 15.

⁷² Rregullorja për ankesat e paraqitura nga fëmijët, neni 17.

⁷³ Ex officio është një term latin që do të thotë “nga zyra”. Në këtë kuptim, kjo do të thotë se IAP-ja kishte të drejtë të ngrinte një rast në bazë të pushtetit të zyrës. Kjo nënkupton se nuk ishte një rast i paraqitur nga një ankues individual i fëmijëve, por nga vetë IAP-ja në emër të një grupi fëmijësh, sepse ata kishin dëgjuar për shkeljen e të drejtave të tyre.

Hapi 2

Për t'i konfirmuar pretendimet, IAP-ja u shkroi letra kryetarëve të të gjitha komunave në Kosovë, duke shtruar pyetje konkrete nëse komuna e tyre po ndërmerre veprime në përputhje me ligjin. Aty ku nuk u dhanë përgjigje, letra  doqën me një kërkesë të dytë.

Hapi 3

Stafi i IAP-së ka analizuar kornizën ligjore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të kuptuar më mirë se çfarë kërkon ligji nga komunat. Kjo përfshiu citimin e nenit 28 të KDF-së dhe të Ligjit Nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Më pas stafi shqyrtoi faktet e rastit në lidhje me secilën komunë. Ata konstatuan se 21 komuna kishin krijuar ekipe të vlerësimit dhe të mbështetjes profesionale për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, në përputhje me ligjin, porse 17 komuna nuk kishin vepruar kështu dhe për këtë arsye kishin shkelur të drejtat e fëmijëve në këtë rast.



Hapi 4

IAP-ja u bëri rekomandime komunave përmes shkresës së tyre – atyre u tha që ta respektojnë ligjin dhe t'i përmbushnin të drejtat e të gjithë fëmijëve në komunitetin e tyre dhe të siguronin arsim gjithëpërfshirës për të siguruar që vlerësimet të bëhen.



Hapi 5

Pasi janë bërë rekomandimet, IAP-ja i ka përcjellë ato pas një periudhe prej një muaji për të parë se çfarë progresi është bërë dhe ua ka kujtuar komunave detyrën e tyre që ta respektojnë ligjin.

Shembulli i mësipërm është vetëm një rast ex officio, në të cilin IAP-ja ka punuar më heret për të siguruar që të drejtat e të gjithë fëmijëve mbrohen dhe respektohen nga shteti. Më shumë informacion rreth këtij rasti mund të gjeni në faqen e internetit të IAP-së [këtu](#).



Duart lart!

Kjo është mundësia e fundit për fëmijët që “ta pyesin ekspertin”. Ata duhet të ftohen të ngrenë duart dhe t'i bëjnë pyetje trajnuesit për procesin e ankesave apo rolin e IAP-së. Mos u

shqetësoni nëse nuk jeni në gjendje t'u përgjigjeni pyetjeve të detajuara ose komplekse! Ju lutemi mbani shënim pyetjen dhe më pas telefononi mësuesin e fëmijës për t'i dhënë përgjigje. Nëse fëmija ngre çështje të ndjeshme ose dëshiron të raportojë një rast aty personalisht, ju lutemi vazhdoni privatisht dhe respektoni procedurat normale të mbrojtjes! Mos i diskutoni rrethanat individuale me fëmijët në një mjedis klase!

Pyetjet e sugjeruara për të filluar diskutimin përfshijnë:

Çka dëshironi të dini për Avokatin e Popullit?

A keni ndonjë sugjerim për punën e tij?

Cilat çështje do të duhej t'i shikonte më në detaje?

Këshillë: Ndonjëherë fëmijët mund të kenë frikë të bëjnë pyetje, kështu që ju lutemi t'i qetësoni ata duke u thënë se “nuk ka pyetje pa kuptim”, duke u përpjekur të krijoni një atmosferë relaksimi.

PËRMBYLLJE

Ky është fundi i trajnimit me fëmijët. Për ta përfunduar seancën, ne sugjerojmë që trajnuesit t'i ndërmarrin katër hapa të qartë:

- 1) Jini të qartë për fëmijët se Institucioni i Avokatit të Popullit është në gjendje t'i mbështesë ata nëse të drejtat e tyre shkelen. **Rikujtoni atyre detajet e kontaktit të IAP-së** dhe metodat e raportimit (p.sh. me telefon, faqe në internet, e-mail ose letër).
- 2) **Inkurajoni fëmijët të qëndrojnë të angazhuar në të drejtat e njeriut dhe në të drejtat e fëmijëve.** Një mënyrë për ta bërë këtë mund të jetë ndjekja e zyrës së Avokatit të Popullit në mediat sociale (Facebook). Të vazhdojnë të bëjnë pyetje dhe të lexosh për të drejtat e njeriut është gjithashtu një mënyrë tjetër e shkëlqyer për të qëndruar të informuar.
- 3) Kërkojuni fëmijëve ta plotësojnë për herë të dytë Pjesën 1 të **formularit të vetëreflektimit** si dhe Pjesën 2 (shih Shtojcën A). Kjo do t'i mundësojë Avokatit të Popullit ta kuptojë se sa i suksesshëm ka qenë trajnimi dhe fushat e trajnimit të mëtejshëm që mund të jenë të dobishme për fëmijët.
- 4) **Falënderoni shkollën dhe, më e rëndësishmja, fëmijët** për vëmendjen, interesimin dhe kohën e tyre sot!

SHTOJCAT

Aneksi A: Formulari i vetëreflektimit

Udhëzime për Prezantuesit: Ju lutemi printoni dy kopje letre të Pjesës 1 për fëmijë dhe dy kopje të Pjesës 2 për fëmijë.

Për ta kursyer letrën, merrni parasysh ta bëni këtë në anën e pasme të së njëjtës fletë.

Pjesa 1 (T'u jepet fëmijëve në fillim dhe në fund të trajnimit)

Mosha e fëmijës:

Gjinia e fëmijës:

Shkolla:

Qyteti/fshati:

Sa i kuptoni fushat e mëposhtme? Shënoni kutinë që përputhet me nivelin tuaj të njohurive!

Deklaratë <i>Njohuria ime/kuptimi im i ...</i>	Kufizuar	Mesatar	Mirë	Shkëlqyeshëm	Nuk jam i/e sigurt
Cilat janë të drejtat e njeriut?					
Cilat janë të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e mia?					
Të drejtat e mia në kontekstin rajonal.					
Të drejtat e mia në kontekstin kombëtar.					
Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve.					
Çka bën Komiteti i KDF-së?					
Si mund të marr pjesë në punën e Komitetit të KDF-së?					
Si mund t'i mbrojë shteti të drejtat e mia?					
Si mund t'i mbrojnë prindërit/kujdestarët e mi të drejtat e mia?					
Çka është Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës?					
Si i mbron të drejtat e mia Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës?					
Si i heton Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës shkeljen e të drejtave?					
Si ta kontaktoni Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës për shkeljet e të drejtave?					
Kush mund të më mbështes nëse					

mendoj se dikush ka shkelur të drejtat e mia?					
---	--	--	--	--	--

Pjesa 2 (T'u jepet fëmijëve në fund të trajnimit së bashku me Pjesën 1)

Tri gjëra që mësova për të drejtat e fëmijëve dhe/ose IAP-në:

1. ...
2. ...
3. ...

Tri gjëra që do të doja të dija për të drejtat e fëmijëve dhe/ose IAP-në:

1. ...
2. ...
3. ...

Aneksi B: Kartolinat e KDF-së për fëmijët më të vegjël

Aneksi C: Kartolinat e KDF-së për fëmijët më të mëdhenj